



Rrjeti - NATYRA 2000

# **PERQASJE INOVATIVE PER PERCAKTIMIN E KUFIJVE TE ZONAVE NATURA 2000**

## **Rast Studimor: pSCI Liqeni i Shkodrës**

**Përgatitur nga: MSc. Daniela Mane**

**Tetor 2023**

---

## Lista e shkurtimeve

AdZM-të	Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BE	Bashkimi Evropian
BIONNA	Rrjeti i të Dhënave të Biodiversitetit në Shqipëri
CBD	Konventa për Diversitetin Biologjik
CLC	Kategoritë e mbulesës së tokës sipas CORINE
DD	Nuk ka të dhëna të mjaftueshme
EN	I Rrezikuar
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KE	Komisioni Evropian
LC	Interes i ulët Ruajtjeje
LR	Rrezik i ulët
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NT	Pothuajse i rrezikuar
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
pSCI	Zonë e propozuar me Rëndësi Komunitare
SAC	Zonave të Veçanta të Ruajtjes
SCI	Zonë me Rëndësi Komunitare”
SPA	Zona Veçanërisht të Mbrojtura
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VU	I Përkeqësuar
WiMS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Jetën e Egër
ZPT	Zona e Përdorimit Tradicional
ZQ	Zona Qendrore
ZR	Zona Rekreative

---

# PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	2
LISTA E FIGURAVE	4
LISTA E TABELAVE	4
<b>1 HYRJE</b>	<b>5</b>
1.1 DIREKTIVAT EVROPIANE PËR RUAJTJEN E NATYRËS	6
1.2 RRJETI NATURA 2000	6
1.3 PROJEKTI	7
<b>2 METODOLOGJIA</b>	<b>8</b>
2.1 ZGJERIMI I RRJETIT NATURA 2000	8
2.2 QASJA INOVATIVE BAZUAR NË EKOSISTEM	9
2.2.1 PËRSE NJË QASJE INOVATIVE	9
2.2.2 QASJA INOVATIVE BAZUAR NË EKOSISTEM	10
2.2.3 PROCESI ME PJESËMARRJE	13
<b>3 ANALIZA E REZULTATEVE</b>	<b>13</b>
3.1 PËRSHKRIMI I ZONËS	13
3.2 VLERAT NATYRORE	15
3.2.1 MBULESA E TOKËS	15
3.2.2 VEGJETACIONI DHE HABITATET KRYESORE N2000	19
3.2.3 LLOJE TË RËNDËSISHME TË FLORËS	27
3.2.4 LLOJE TË RËNDËSISHME TË FAUNËS	28
3.2.5 VLERA KULTURORE	34
3.2.6 VLERA NATYRORE	34
3.3 PRESIONET/KËRCËNIMET	37
3.3.1 INFRASTRUKTURA RRUGORE	38
3.3.2 PESHKIMI I PAKONTROLLUAR	38
3.3.3 KULLOTJA	40
3.3.4 TURIZMI	40
3.3.5 ZJARRET	41
3.3.6 TË TJERA	41
3.3.7 HARTA TOTALE E KËRCËNIMEVE	44
3.4 HARTA ANALITIKE	46
<b>4 PROCESI PJESËMARRËS</b>	<b>51</b>
4.1 TAKIMI I PARË	51
4.2 TAKIMI I DYTË	52
<b>5 PËRFUNDIME E REKOMANDIME</b>	<b>53</b>

---

## Lista e Figurave

Figura 1. Harta e zonave të menaxhimit të RNM Liqeni i Shkodrës .....	14
Figura 2. Harta baze – Kufiri i Parkut dhe Rrjeti kuadratik.....	15
Figura 3. Harta e mbulesës së tokës (Corine 2018) .....	17
Figura 4. Harta e Vlerës së mbulesës së tokës (Corine 2018).....	18
Figura 5. Harta e tipave të vegjetacionit .....	21
Figura 6. Harta e vlerës së tipave të vegjetacionit .....	22
Figura 7. Harta e habitateve kryesore të parkut .....	24
Figura 8. Harta e vlerës së habitateve dhe zonave të rëndësishme .....	25
Figura 9. Harta e vlerës së habitateve dhe zonave të rëndësishme .....	26
Figura 10. Harta e vrojttimeve të llojeve të kafshëve .....	32
Figura 11. Harta e Vlerës së llojeve të kafshëve.....	33
Figura 12. Harta e Vlerës totale natyrore .....	35
Figura 13. Harta e Vlerës totale natyrore krahasuar me zonimin e parkut.....	36
Figura 14. Shpërndarja e sipërfaqes sipas klasave të vlerësimit të vlerës natyrore .....	37
Figura 15. Harta e ndikimit të rrjetit rrugor dhe zonat urbane .....	39
Figura 16. Harta e zonave që ndikohen nga aktivitetet kryesore .....	43
Figura 17. Shpërndarja e sipërfaqes sipas klasave të rrezikut.....	44
Figura 18. Harta e vlerës së kërcënimeve .....	45
Figura 19. Shpërndarja e sipërfaqes sipas klasave të përshtatshmërisë për ruajtjen e natyrës .....	46
Figura 20. Harta e përshtatshmërisë për ruajtjen e natyrës (Vlera totale).....	47
Figura 21. Kufiri i propozuar për zonën Natura 2000.....	48
Figura 22. Shpërndarja e sipërfaqes sipas klasave të konfliktit .....	49
Figura 23. Kufiri i propozuar për zonën Natura 2000 me zonat e konfliktit.....	50
Figura 24. Modeli konceptual Liqeni i Shkodrës.....	53

## Lista e Tabelave

Tabela 1: Mbulesa e tokës sipas Corine 2018.....	16
Tabela 2: Lista e tipave të vegjetacionit në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës .....	19
Tabela 3: Lista e llojeve të bimëve të rëndësishme në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës.....	27
Tabela 4. Lloje të faunës sipas grupeve kryesore që hasen në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës..	28
Tabela 5. Lloje të faunës sipas kategorive të rrezikimit sipas Listës së Kuqe të IUCN.....	28
Tabela 6. Lloje të faunës sipas grupeve kryesore të vrojtuar në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës .....	30
Tabela 7. Lloje të faunës të Vrojtuar sipas kategorive të rrezikimit sipas Listës së Kuqe të IUCN .....	31
Tabela 8. Identifikimi i zonave të konfliktit .....	49



---

# 1 Hyrje

Shqipëria konsiderohet një pikë e nxehtë e biodiversitetit në Evropë. Megjithatë, vërehet se një biodiversitet i tillë i jashtëzakonshëm dhe burime të vlefshme natyrore po përballen me sfida. Si vendet e tjera në zhvillim, edhe Shqipëria po përballlet me një zhvillim të shpejtë. Rrugët dhe infrastrukturat e reja, digat, hidrocentralet, rezervuarët e naftës dhe infrastruktura e turizmit masiv synojnë të rrisin ekonominë e vendit, ndërkohë që përbëjnë një kërcënim serioz për mbrojtjen e natyrës.

Sipas Raportit të 6-të Kombëtar të Konventës për Diversitetin Biologjik (CBD) (2019), faktorët kryesorë të humbjes së diversitetit biologjik janë aktivitetet antropogjenë. Kërcënimet kryesore për biodiversitetin përfshijnë: zhvillimin industrial, urbanizimin, gjuetinë e paligjshme, peshkimin, erozionin e tokës, energjinë dhe minierat, transportin dhe turizmin.

Duke njohur rolin e rëndësishëm që kanë zonat e mbrojtura në ruajtjen e biodiversitetit, Shqipëria ka bërë përpjekje për krijimin dhe zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura. Në veçanti, vendi ka bërë përpunim të rëndësishëm në përmirësimin e mbulimit të sistemit të tij të zonave të mbrojtura gjatë 20 viteve të fundit, duke zgjeruar në mënyrë të ndjeshme shtrirjen e zonave të mbrojtura nga 163,901 ha (5.7%) në 2000, në 460,762 ha (16%) në 2015 dhe në 624.172 ha (21.7%) në 2023.

Integrimi në BE është prioritet kryesor për Qeverinë shqiptare. Shqipëria është vend kandidat për në Bashkimin Evropian. Si pjesë e procesit të pranimit, për më shumë se një dekadë, Shqipëria po punon intensivisht në transpozimin e Direktivave të BE-së në legjislacionin e saj kombëtar.

Direktivat për Shpendët e Egër dhe Habitatet janë pjesa qendrore e përpjekjeve evropiane për ruajtjen e natyrës. Këto direktiva të rëndësishme rregullojnë mbrojtjen e specieve dhe habitateve nëpërmjet krijimit dhe menaxhimit të duhur të një rrjeti të zonave të mbrojtura të njohur si rrjeti Natyra 2000.

Në Raportin e tij të Progresit 2022 për Shqipërinë, Komisioni Evropian (KE) vëren se përafrimi i legjislacionit kombëtar me *acquis* në fushën e mbrojtjes së natyrës, veçanërisht për Direktivat e Shpendëve dhe Habitateteve, është mjaft i avancuar. Megjithatë, zbatimi është në një fazë shumë fillestare dhe përballlet me një sërë sfidash, duke përfshirë kapacitetet e dobëta institucionale, bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet strukturave përgjegjëse qeveritare, përfshirjen e kufizuar të institucioneve akademike dhe kërkimore dhe mungesën e burimeve adekuate financiare. Mungesa e hartave të detajuara të habitateve që mbulojnë të gjithë vendin si dhe niveli i kufizuar i njohurive mbi habitatet dhe shpërndarjen e llojeve pengon identifikimin dhe mbrojtjen e duhur të zonave përkatëse si dhe zgjedhjen dhe zbatimin e masave të duhura të ruajtjes.

Raporti vuri në dukje gjithashtu se zbatimi i ligjit në mbrojtjen e mjedisit mbetet përgjithësisht i dobët. Për më tepër, legjislacioni për investimet strategjike ngre shqetësime për mbrojtjen e biodiversitetit, pasi mund të çojë në investime të mëdha turistike dhe industriale në zonat e mbrojtura. Vëmendja e duhur duhet t'i kushtohet hartimit të projekteve dhe cilësisë e standardeve për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) për të minimizuar ndikimet e mundshme.

Shqipëria ka identifikuar një listë paraprake të zonave të Natura 2000 në të gjithë vendin, të cilat do ti paraqiten Komisionit Evropian, duke kontribuar në këtë mënyrë në përputhjen e kuadrit rregullator të vendit me *acquis* mjedisore të BE-së.

---

## 1.1 Direktivat Evropiane për ruajtjen e natyrës

Gurët themelorë të Evropës për politikën e ruajtjes së natyrës janë padyshim Direktiva e Shpendëve dhe Habitaveve. Ato janë legjislacioni më i vjetër evropian për mjedisin. Këto direktiva mbrojnë mbi 1000 lloje dhe më shumë se 200 habitate dhe janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare.

Miruar në 1992, Direktiva e Këshillit 92/43/EEC e 21 majit 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër synon të promovojë ruajtjen e biodiversitetit, duke marrë parasysh kërkesat ekonomike, sociale, kulturore dhe rajonale. Direktiva mbështet krijimin e rrjetit ekologjik Natura 2000 në mbarë BE-në, si një rrjet i zonave të mbrojtura që synon ruajtjen e vlerave natyrore kundër zhvillimeve potencialisht të dëmshme.

Direktiva e Habitaveve siguron ruajtjen e një game të gjerë specimesh të rralla, të kërcënuara ose endemike të kafshëve dhe bimëve. Rreth 200 lloje habitatesh<sup>1</sup> të rralla dhe karakteristike janë të synuara për t'u ruajtur duke përcaktuar Zona të Veçanta të Ruajtjes, për të cilën zbatohet një legjislacion i përbashkët në mbarë BE-në. Pesë shtojca të kësaj direktive përcaktojnë habitatet dhe llojet që duhen ruajtur në nivel Evropian, kriteret që përdoren për përzgjedhjen e zonave që janë të pranueshme për t'u njohur si të rëndësishme për Evropën, ose si zona të veçanta të ruajtjes si dhe llojet për të cilët zbatohet një regjim i rreptë mbrojtjeje në të gjithë arealin e tyre natyror brenda BE-së, si brenda dhe jashtë zonave Natura 2000, apo për të cilat Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që shfrytëzimi dhe marrja e tyre në natyrë është në përputhje me mbajtjen e tyre në një status të favorshëm ruajtjeje.

Direktiva e shpendëve ofron një kuadër ligjor për mbrojtjen e shpendëve, duke përfshirë foletë, vezët dhe habitatet e tyre. Nëpërmjet pesë shtojcave, Direktiva ka mbuluar përcaktimin e zonave të mbrojtura, habitatet për shpendët e egër, mbrojtjen e specieve dhe rregulloret e gjuetisë. Humbja dhe degradimi i habitatit janë kërcënimet më serioze për ruajtjen e shpendëve të egër. Prandaj, Direktiva vë theks të madh në mbrojtjen e habitateve për speciet e rrezikuara dhe migratore. Ajo krijon një rrjet të Zonave të Mbrojtjes së Veçantë (SPA), duke përfshirë të gjitha territoret më të përshtatshme për këto specie. Që nga viti 1994, të gjitha SPA-të përfshihen në rrjetin ekologjik Natura 2000, i krijuar sipas Direktivës së Habitaveve 92/43/EE.

## 1.2 Rrjeti Natura 2000

Zbatimi i rrjetit Natura 2000 (N2K) është përpjekja më e rëndësishme e ruajtjes në Evropë, duke formuar rrjetin më të madh në botë të zonave nën mbrojtje. Qëllimi i saj është të sigurojë mbijetesën afatgjatë të specieve dhe habitateve më të vlefshme dhe më të kërcënuara të Evropës.

Ky rrjet përbëhet nga Zonat e Veçanta të Mbrojtjes (SPAs) – të kërkuara sipas Art. 4(1) dhe 4(2) të Direktivës së Shpendëve (2009/147/KE) – dhe Zonat me Rëndësi Komunitare (SCIs) të miratuara dhe më pas të përcaktuara nga Shteti Anëtar si Zona të Veçanta të Ruajtjes (SAC) – të treguara sipas Direktivës së Habitaveve (92/43/CEE). SPA-të janë zona të mbrojtura për speciet e rralla, të kërcënuara, por edhe migratore të shpendëve të listuar në shtojcën I të Direktivës së Shpendëve, ndërsa, SCI-të dhe SAC-et janë zona që synojnë ruajtjen respektivisht të habitateve dhe llojeve të shtojcës I dhe shtojcës II të Direktivës së Habitaveve. Vendet kandidatë janë të detyruara t'i klasifikojnë vetë zonat para pranimit dhe të njoftojnë Komisionin Evropian për përmbushjen e këtij detyrimi. Përcaktimi i zonave Natura 2000 bazohet në 194 lloje shpendësh, 233 habitate dhe rreth 900 lloje bimore dhe 1550 lloje kafshësh që kërkojnë mbrojtje.

---

<sup>1</sup> mbi 233 në ditët e sotme duke përfshirë 71 habitate prioritare

---

Procesi i përzgjedhjes së zonave Natura 2000 bazohet me anë të rajoneve biogeografike. Evropa është e ndarë në nëntë rajone biogeografike, duke përfshirë Alpine, Atlantik, Detin e Zi, Boreal, Kontinental, Mesdhetar, Macaronesia, Pannonian, Steppic. Vlerësimi i propozimeve të reja të Shteteve Anëtare kryhet nëpërmjet një sërë seminaresh për çdo rajon biogeografik. Në këto seminare, përfaqësues nga Shtetet e reja Anëtare, Komisioni Evropian, OJQ-të mjedisore dhe ekspertët e pavarur vlerësojnë nëse fushat e propozuara nga qeveritë kombëtare janë koherente me dhënien e Direktivës së Habitave dhe Zogjeve si dhe ato ofrojnë mbrojtjen e duhur për të gjitha speciet dhe habitatet e rrezikuara brenda rajoneve bio-gjeografike të interesuara.

Përzgjedhja e zonave që do të përfshihen në rrjetin Natura 2000 është një përgjegjësi e përbashkët midis Shteteve të reja Anëtare të BE-së dhe Komisionit Evropian dhe ajo bazohet ekskluzivisht në kriteret shkencore (pra madhësia e popullsisë dhe dendësia e specieve të synuara, zona dhe cilësia ekologjike e llojeve të habitatit të synuar të pranishëm në sit). Në datën e pranimit, vendet hyrëse duhet t'i propozojnë Komisionit Evropian një listë kombëtare të vendeve (vendet e propozuara me rëndësi komunitare, ose pSCI) të përcaktuara për të mbrojtur ato habitate dhe lloje të Direktivës së Habitave dhe Zogjeve që ndodhin në territorin e tyre kombëtar. Pasi të paraqitet lista, Komisioni vlerëson koherencën e vendeve të reja dhe më në fund i miraton ato si Site me Rëndësi Komunitare (SCI). Kur një zonë e caktuar bëhet SCI, Shteti Anëtar ka gjashtë vjet për ta përcaktuar atë një Zonë të Veçantë të Konservimit (SAC).

Qëllimi i Direktivës së Habitave është krijimi i një 'statusi të favorshëm të ruajtjes' për llojet e habitave dhe speciet e zgjedhura për të qenë me rëndësi komunitare. Përkufizimi i "gjendjes së favorshme të ruajtjes" të habitave dhe specieve përshkruhet në nenin 1 të Direktivës. Kjo është përcaktuar gjerësisht si për habitatet ashtu edhe për speciet duke iu referuar faktorëve të tillë si dinamika e popullsisë së specieve, prirjet në gamën natyrore të specieve dhe habitave dhe zonën e habitave të mbetura.

### 1.3 Projekti

Projekti "Fuqizimi i OJQ-ve Shqiptare për të mbështetur krijimin dhe menaxhimin e rrjetit Natyra 2000 në Shqipëri / Mbrojtja e Biodiversitetit", financuar në kuadër të programit Green-AL, synon mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile për të siguruar një kontribut cilësor dhe pjesëmarrje aktive të grupeve të interesit në mbështetje të procesit të krijimit dhe menaxhimit të rrjetit të zonave Natyra 2000 në Shqipëri, nëpërmjet ngritjes së një rrjeti kombëtar të organizatave të shoqërisë civile, i aftë për bashkëpunim dhe advokim në politikat kombëtare për ruajtjen e habitave dhe llojeve të rëndësishme në nivel Evropian.

Projekti synon të çojë përpara vizionin e Natyra 2000 në Shqipëri për të konsideruar urat midis natyrës dhe njerëzve si një vlerë e shtuar për mbrojtjen e biodiversitetit. Projekti synon të japë një model inovativ bazuar në bindjen e fortë se objektivat e ruajtjes së biodiversitetit mund të arrihen më lehtë kur vendosen marrëdhënie të favorshme ndërmjet mbrojtjes së natyrës dhe aspekteve socio-ekonomike. Kjo nënvizon nevojën për të angazhuar publikun e gjerë në procesin e krijimit dhe menaxhimit të zonave Natura 2000 nëpërmjet praktikave të planifikimit dhe vendimmarrjes politike me pjesëmarrje.

Përmes aktiviteteve dhe produkteve të këtij projekti do të advokohet në nivel kombëtar për një qasje nga poshtë-lart e mundur nga rrjetëzimi dhe pjesëmarrja aktive e OSHC-ve dhe palëve të interesuara. Ky model do të mundësojë zbutjen e kundërshtimeve dhe konflikteve në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të zonave Natyra 2000, duke marrë në konsideratë nevojat e komunitetit lokal dhe të palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes. Për ta konkretizuar më



---

mirë këtë iniciativë është punuar praktikisht në tre zona pilote, të cilat përfaqësojnë edhe tre kategori të ndryshme të territoreve të zonave të mbrojtura kandidate për Natyra 2000, siç janë: Rezervati i Menaxhuar Natyror Liqeni i Shkodrës, Parku Kombëtar Shebenik, dhe Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan.

## 2 Metodologjia

### 2.1 Zgjerimi i rrjetit Natura 2000

Zgjerimi i rrjetit Natura 2000 drejt vendeve të reja anëtare të BE është një sfidë. Vendet e reja sjellin trashëgimi natyrore shtesë në BE, duke përfshirë dhe peizazhet e pasura kulturore. Efekti pozitiv i zgjerimit të BE-së mund të shoqërohet me efekte anësore të padëshiruara ndaj vlerave natyrore. Rrugët e reja tregtare, zgjerimi i infrastrukturës, praktikat intensive bujqësore, mund të ndikojnë në ekosistemet natyrore me një sërë kërcënimesh dhe presionesh. Këto efekte negative shumëfishojnë ndikimet ekzistuese njerëzore që prekin zonat natyrore tashmë nën kërcënim ose të humbura në mënyrë të pariparueshme.

Për të shmangur humbjet e pakthyeshme, përgjatë procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, vendet kandidate, si Shqipëria, duhet të transpozojnë dispozitat e Direktivave të Shpendëve dhe Habitave në legjislacionin e tyre kombëtar dhe të përgatisin kushtet për vendosjen e Natura 2000 në territorin e tyre deri në datën e pranimit. Ky proces harmonizimi përfaqëson hapin paraprak për zbatimin e Natura 2000 në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Ai përfshin plotësimin dhe dërgimin e një liste të zonave të propozuara me rëndësi komunitare (pSCI) pranë Komisionit Evropian dhe verifikimin e tyre gjatë një procesi diskutimi me bazë rajonet biogeografike.

Për të evituar humbjet e pakthyeshme të biodiversitetit dhe komplikimet e paparashikuara, zbatimin e rrjetit Natura 2000 duhet të jetë skrupuloz dhe i planifikuar siç duhet që në fazën më të hershme të mundshme. Në të kaluarën, vendime jo të mençura dhe jo të rregullta shpesh kanë çuar në konflikte serioze ose, ndonjëherë, në pasoja të paimagjinueshme për trashëgiminë natyrore. Mungesa e informacionit mbështetës mbi zhvillimin e rrjetit Natura 2000 apo shpjegimi i mangët mbi implikimet e Direktivave të Habitave dhe Shpendëve kanë shkaktuar keqkuptime si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar.

Në shumë raste, qeveritë kombëtare janë paraqitur para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (p.sh. Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Holanda) për të sqaruar bllokimet dhe vonesat në zhvillimin e rrjetit Natura 2000. Gjithashtu, qeveritë e shumë Shteteve Anëtare të BE-së historikisht kanë nënvlerësuar rëndësinë kyçe të mbledhjes së të dhënave shkencore me anë të qasjeve multi-disiplinare. Vite më parë, kishte edhe një farë neglizhence për të përfshirë organizmat jo-institucionale (p.sh. OJQ-të) në procesin e përzgjedhjes së zonave. Përfshirja dhe pjesëmarrja e publikut ishte edhe më e kufizuar në disa vende të largëta të Evropës Qendrore dhe Lindore për shkak të trashëgimive të lidhura me historinë, si centralizimi i lartë i sistemeve të mëparshme qeveritare (p.sh. modelet sovjetike).

Nisur nga ky realitet i pakënaqshëm, vitet e fundit vendet e BE-së filluan ta përmbysin këtë prirje duke sjellë një tendencë në rritje për të bashkuar aktorë të ndryshëm në procesin e vendim-marrjes për përcaktimin e zonave Natura 2000. Pavarësisht se direktivat lidhur me Natura 2000 nuk pretendojnë në mënyrë eksplicite pjesëmarrjen e publikut, qasjet multi-aktorësh kanë marrë gjithnjë e më shumë vull në BE (Strategjia e Biodiversitetit të BE-së, Komisioni i Komuniteteve Evropiane 2005). Fakti që sot Evropa zotëron rrjetin më të gjerë të zonave të mbrojtura në botë, që

---

mbulon më shumë se 18% të territorit të saj, është mbështetur padryshim nga ky përmirësim institucional dhe tekniko-shkencor.

Vendet kandidatë për në BE tani mund të përfitojnë nga ekspertiza e akumuluar nga vendet e tjera anëtare që kanë kaluar fazat e para të zbatimit të Natura 2000. Që nga koha e miratimit të parë të rrejtit Natura 2000, zbatimi i politikës së ruajtjes së natyrës është bërë gjithnjë e më kërkuar. Përfshirja e grupit më të gjerë të mundshëm të aktorëve (organizatave joqeveritare, anëtarëve të komunitetit etj.), veçanërisht në nivel lokal, është e një rëndësie vendimtare. Trajnimet profesionale për ekspertët vendas janë një instrument thelbësor për të ndihmuar procesin e themelimit të rrejtit Natura 2000.

## 2.2 Qasja inovative bazuar në ekosistem

### 2.2.1 Përse një qasje inovative

Edhe pse aspektet ekonomike, sociale dhe kulturore përgjithësisht nuk konsiderohen kur përzgjidhet një zonë Natura 2000 (normalisht është një vendim i bazuar në shkencë sipas Nenit. 4.1 të Direktivës së Habitaveve), kjo qasje në përcaktimin e kufijve të zonës synon një përputhje me dispozitat e Nenit. 2.3.2 "Masat e marra në bazë të kësaj Direktive duhet të marrin parasysh kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe karakteristikat rajonale dhe lokale", të cilat portretizojnë më mirë kontekstin specifik të vendit.

Rrejtji Natura 2000, ka një farë fleksibiliteti ndaj aktiviteteve të lejuara brenda SCI-ve dhe SPA-ve. Ndryshe nga standardet e përbashkëta ligjore të sistemeve kombëtare të zonave të mbrojtura (si p.sh. Parqet Kombëtare, Peizazhet e Mbrojtura, Rezervat Natyrore, Monumentet Natyrore, etj.), të cilat zakonisht përfshijnë kufizime fikse që synojnë në përgjithësi mbrojtjen e të gjithë zonës, në zonat Natura 2000 aktivitetet njerëzore dhe proceset jo-natyrore lejohen nëse nuk rrezikojnë llojet dhe specie të habitatit të listuar në anekset e direktivave.

Sigurisht, ekziston nevoja e vlerësimit sipas rasteve për të verifikuar llojin dhe intensitetin e veprimtarive aktuale dhe potenciale që mund të shkaktojnë shqetësim për zonën (zakonisht të përcaktuara ligjërisht në procedurën e quajtur Vlerësimi i Përshtatshëm sipas Art. 6.3) por vizioni i Natura 2000 për të konsideruar urat midis natyrës dhe njerëzve si një vlerë e shtuar për mbrojtjen e biodiversitetit është gjithashtu i rëndësishëm. Njerëzit nuk duhet të shihen vetëm si "bartësit kryesorë të kërcënimit". Një integrim i objektivave të ruajtjes së biodiversitetit me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm po konsiderohet gjithnjë e më shumë në nivelin e BE-së gjatë viteve të fundit.

Qasja e propozuar bazohet në bindjen e fortë se objektivat e ruajtjes së natyrës mund të arrihen më lehtë kur të krijohen marrëdhënie të forta midis mbrojtjes së natyrës dhe aspekteve socio-ekonomike. Procesi i përgjithshëm, përgjatë të cilit trajtohen aktivitetet pjesëmarrëse me palët e interesuara lokale, është i orientuar në mënyrë eksplicite në "atë që njerëzit mund të përfitojnë nga natyra" dhe jo "atë që nuk mund të bëjnë në natyrë", një strategji shumë më efektive për arritjen e qëllimeve afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit të BE-së. Mbi këtë bazë, modeli është zhvilluar me një qasje poshtë-lart të fuqizuar nga pjesëmarrja e madhe e palëve të interesuara lokale (institucionet publike, agjencitë lokale, përdoruesit e burimeve natyrore, peshkatarët, fermerët, barinjët, fshatarët, etj.).

Në të kaluarën, kufizimet e qasjeve tradicionale për përballimin e sfidave të përcaktimit të zonave Natura 2000 kanë shkakuar komplikime të jashtëzakonshme. Konfliktet e palëve të interesuara përgjithësisht lindin nga interesat konkurruese që veprojnë rreth një zone natyrore të caktuar dhe

---

shpesh shkaktohen nga metodat e planifikimit nga lartë-poshtë që shpërfillin nevojat e komunitetit lokal dhe të palëve të interesuara. Kjo thekson nevojën për një qasje me pjesëmarrje edhe për krijimin e rrjetit Natura 2000.

Rëndësia e një procesi pjesëmarrës që lehtëson përfshirjen, konsensusin, negocimin dhe bashkëpunimin e palëve të interesuara është vazhdimisht e theksuar gjatë zbatimit të kësaj qasjeje. Ambicia e qartë e modelit është të ofrojë një udhëzues referimi për mbështetjen e nismave të përcaktimit të zonave Natura 2000 në Shqipëri.

## 2.2.2 Qasja inovative bazuar në ekosistem

Për të garantuar përcaktimin optimal të zonave të rrjetit Natura 2000 dhe planifikimin e strategjive të menaxhimit për mbrojtjen afatgjatë të biodiversitetit propozohet kjo qasje gjithëpërfshirëse me pjesëmarrje që merr në konsideratë përfitimet e shumta prej natyrës, dhe interesat dhe opinionet e një game më të gjerë të palëve të interesuara. Qasja e propozuar vë një theks gjithnjë e më të madh në analizën dhe hartografin e vlerave natyrore, identifikimin e konflikteve të mundshme midis palëve të interesuara dhe identifikimin e rëndësisë dhe vlerës së caktuar të përfitimeve të lidhura me biodiversitetin nga shumë aktorë, si mjete të fuqishme për përdorim në një proces me pjesëmarrje të planifikimit të peizazhit.

Qasja e propozuar e bazuar në ekosistem përfshin 5 grupe aktivitetsesh si më poshtë:

### **I. Vlerësime dhe hulumtime paraprake**

#### ***1.1 Identifikimi i një grupi të aktorëve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë***

Një inventar i palëve të interesuara potenciale duhet të gjenerohet mbi një bazë të gjerë të grupeve lokale të interesit (vendimmarrësit, personeli administrativ përkatës, përfaqësuesit e komunitetit lokal, etj.) dhe sektorët socio-ekonomikë (barinjte, agjencitë e turizmit, peshkatarët, etj.). Të dhënat nga projektet dhe nismat e mëparshme dhe informacionet e ndjeshme mbi palët e interesuara duhet të agregohen dhe të kontrollohen gjatë workshop-eve pjesëmarrëse 1-ditore. Palët e interesuara dhe analizat e problemeve duhet të kryhen për të identifikuar grupet dhe/ose institucionet që kanë një marrëdhënie direkt ose indirekte me zonën e propozuar Natura 2000.

#### ***1.2 Mbledhja e literaturës dhe të dhënave në terren***

Një koleksion i plotë i të dhënave shkencore mbi biodiversitetin e zonës duhet të kryhet nëpërmjet analizës së literaturës shkencore ekzistuese përkatëse, raporteve të projekteve dhe të dhënave rreth zonës së studimit të mbledhura gjatë aktiviteteve të mëparshme të projekteve të ndryshme, duke përfshirë të dhënat e ruajtura në bazat e të dhënave BioNNA dhe WIMS. Eksperti i biodiversitetit duhet të caktojë habitatet dhe speciet bimore dhe shtazore në përputhje me ekspertizën e saj/tij. Të dhënat e mbledhura për çdo habitat dhe specie duhet të përfaqësohen në një format GIS që tregon mbulimin/shpërndarjen e habitateve dhe specieve. Informacione të tjera të rëndësishme mund të mblidhen gjatë takimeve specifike me personelin e administratave lokale të zonave të mbrojtura dhe nga projekte të tjera që punojnë në zonë.

### **II. Mbledhja e të dhënave në terren mbi vlerat natyrore dhe faktorët e kërcënimit dhe presionit**

Eksperti i biodiversitetit duhet të mbledhë informacion mbi speciet e rëndësishme bimore dhe shtazore, komunitetet bimore dhe llojet e habitateve, si dhe të mbledhë prova mbi presionet dhe kërcënimet. Çdo aktivitet në terren duhet të kryhet në bashkëpunim të fortë me personelin lokal të administratës së zonave të mbrojtura.



---

Aktivitetet e mbledhjes së të dhënave do të kontribuojnë në hartografimin e vlerave natyrore dhe analizën e saktë mbi biodiversitetin e zonës. Këto të dhëna do të ndihmojnë gjithashtu në kuptimin e përfitimeve të perceptuara dhe vlerësimin e konflikteve të mundshme midis ruajtjes së natyrës dhe palëve të interesuara lokale. Studimi do të synojë identifikimin dhe përcaktimin e vlerave natyrore dhe përfitimeve të shumta që zona e studimit u jep palëve të interesuara lokale, duke vlerësuar problemet kryesore dhe sektorët/palët e interesuara në konflikte, në mënyrë që të mbështesin procesin e planifikimit me pjesëmarrje të zonë Natura 2000, në veçanti përcaktimin e kufijve të saj.

### **III. Zhvillimi i një baze të dhënash të integruar**

Si rezultat i të dhënave të marra nga literatura dhe studimet e mëparshme si dhe nga vërtetimet në terren, do të ndërtohet një inventar i integruar i të dhënave mbi vlerat natyrore dhe kërcënimet dhe presionet ndaj tyre. Të gjitha të dhënat e grumbulluara do të jenë të gjeo-referencuara dhe të diskutuara me palët e interesuara. Bazuar në të dhënat e grumbulluara do të përgatiten listat e referencës me tipet e habitateve dhe llojet nga Direktivat e Shpendëve dhe Habiteteve që janë të pranishme në zonë. Të dhënat do të përdoren për të prodhuar hartat e listuara në seksionin e mëposhtëm (hartat tematike, hartat analitike, etj.).

### **IV. Interpretimi i të dhënave dhe analiza hapësinore**

Të gjitha të dhënat mbi vlerat natyrore dhe presionet e kërcënimit ndaj tyre do të hartografohen dhe interpretohen mbi bazën e konsideratave teorike, qasjeve praktike dhe konsultimeve me palët e interesuara lokale. Rezultatet do të paraqiten nëpërmjet një sërë hartash tematike. Rendi i hartave ndjek logjikën e procesit dhe synon lehtësimin e kuptimit të qasjes metodologjike të aplikuar. Në vijim janë tipet dhe përshkrimet e hartave që do të përgatiten:

#### ***Hartat bazë***

- 1 Kufiri i zonës së projektit - Harta që tregon kufirin e përgjithshëm të zonës së studimit (kjo mund të jetë më e gjerë se zona e propozuar)
- 2 Zonat ekzistuese të mbrojtura – Harta që tregon kufijtë dhe kategorinë e menaxhimit të zonave ekzistuese të mbrojtura brenda zonës së studimit
- 3 Rrejtja kuadratik - Kjo hartë shfaq rrjetën kuadratikë që do të përdoret për të analizuar vlerat, burimet natyrore të zonës, dhe intensitetin e rrezikut për bimësinë, bimët dhe speciet shtazore. Rrjeti kuadratik është pjesë e rrjetit origjinal kuadratikë përgatitur nga Agjencia Evropiane e Mjedisit. Rrjeti është pjesë e sistemeve gjeografike sipas Direktivës INSPIRE. Rrjeti vjen në poligone kuadratikë me brinjë 1, 10 dhe 100 km. Për analizën e zonave Natura 2000 në Shqipëri do të përdoret rrjeti prej 1 km, i përshtatur me kufijtë e zonës së projektit.
- 4 Mbulesa e tokës - Kjo hartë shfaq mbulesën e tokës sipas përdorimit dhe vegjetacionit duke përdorur klasifikimin e sistemit CORINE, niveli i tretë.

#### ***Vlerat natyrore***

- 5 Harta e vegjetacionit – Kjo hartë tregon llojet e bimësisë brenda zonës së studimit siç identifikohet nga literatura dhe mbledhja e të dhënave të depozituara.
- 6 Vlera e vegjetacionit – Kjo hartë shfaq vlerën e vegjetacionit në një rezolucion prej 1 km<sup>2</sup> (rrjeti kuadratik)

- 
- 7 Harta e llojeve të rëndësishme bimore – Kjo hartë tregon praninë (pikën) e llojeve të rëndësishme bimore (të rrezikuara, endemike, të renditura në direktivat e BE-së) brenda zonës së studimit.
  - 8 Vlera e llojeve bimore - Kjo hartë shfaq vlerën e secilit kuadrat 1 km<sup>2</sup> në bazë të numrit të vrojttimeve të regjistruara brenda çdo qelize të rrjetit kuadratik.
  - 9 Harta e habitateve – Kjo hartë do të tregojë mbulimin e habitateve me interes të ruajtjes së komunitetit (Direktiva e Habitatit) që ndodhin brenda zonës së studimit.
  - 10 Vlera e habitateve – Kjo hartë tregon proporcionin e llojeve të habitatit në çdo qelizë të rrjetit kuadratik.
  - 11 Harta e llojeve të rëndësishme shtazore - Kjo hartë tregon praninë (pikën) e llojeve të rëndësishme shtazore (të rrezikuara, endemike, të renditura në direktivat e BE-së) brenda zonës së studimit.
  - 12 Vlera e llojeve shtazore – Kjo hartë shfaq vlerën e secilit kuadrat 1 km<sup>2</sup> në bazë të numrit të vrojttimeve të regjistruara brenda çdo qelize të rrjetit kuadratik.

#### ***Vlerat kulturore***

- 13 Harta e vlerave kulturore - Kjo hartë tregon praninë (pikën, poligonin) e vlerave të rëndësishme historike, shpirtërore dhe kulturore (site historike dhe kulturore, duke përfshirë arkeologjinë) brenda zonës së studimit.
- 14 Vlera kulturore e zonës – Kjo hartë tregon proporcionin e vlerave kulturore në çdo qelizë të rrjetit kuadratik.

#### ***Presionet dhe kërcënimet***

- 15 Harta e rrjetit rrugor – Kjo hartë tregon të gjitha rrugët e kategorive të ndryshme dhe shtigjet e ecjes brenda zonës së studimit
- 16 Harta e infrastrukturës turistike - Kjo hartë tregon të gjitha llojet e ndryshme të objekteve dhe hapësirave brenda zonës së studimit që përdoren nga vizitorët (duke përfshirë restorante, hotelet, qendrat e vizitorëve, vendet e kampingut, vendet e piknikut etj.).
- 17 Ndikimi i rrjetit rrugor – Kjo hartë tregon ndikimin e rrjetit rrugor në zonë vlerësuar në një distancë të caktuar në të dy anët e rrugëve apo shtigjeve.
- 18 Ndikimi i aktiviteteve turistike – Kjo hartë tregon zonat më së shumti të përdorura për turizëm dhe aktivitete rekreative.
- 19 Harta e rrezikut të zjarreve – Kjo hartë tregon zonat që preken apo mund të preken nga zjarret sipas të dhënave historike dhe perceptimit të palëve të interesuara.
- 20 Harta e ndikimit të kullotjes – Kjo hartë tregon zonat që përdoren zakonisht për kullotje, duke përfshirë shtigjet lëvizëse të kafshëve, kasollet dhe pikat e ujit (lerat).

#### ***Harta analitike***

- 21 Harta e vlerës natyrore – Kjo hartë tregon zonat më të vlefshme si kombinim i vlerës së bimësisë, proporcionit të habitatit, vlerave të llojeve (bimore dhe shtazore) dhe vlerave kulturore.
- 22 Harta e kërcënimeve/rreziqeve – Kjo hartë tregon zonat më të rrezikuara si kombinim i të gjitha rreziqeve (efekti i rrugëve, turizmi, zjarret dhe kullotja)
- 23 Harta e zonave të konfliktit – kjo harta tregon mbivendosjen e zonave më të vlefshme me zona të rrezikshme si një kombinim i dy hartave të mëparshme (21 dhe 22)
- 24 Kufijtë e propozuar të zonës Natura 2000 – kjo hartë do të tregojë kufijtë e propozuar për sitin Natura 2000 duke marrë parasysh të gjitha analizat e mësipërme.

---

## 2.2.3 Procesi me pjesëmarrje

Procesi me pjesëmarrje është i rëndësishëm për të siguruar mirëkuptim mbi nevojën e ruajtjes së vlerave natyrore dhe diskutuar bashkërisht mbi vlerat natyrore, kërcënimet dhe presionet aktuale dhe potenciale ndaj tyre si dhe masat që duhen ndërmarrë për të ruajtur të paprekur trashëgiminë natyrore kaq të rëndësishme, si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar/ndërkombëtar. Për këtë qëllim do të realizohen një numër takimesh (workshope) me palët e interesuara dhe aktorët lokale, ku jo vetëm do të jepen informacione mbi parimet bazë të konceptit Natura 2000, por edhe do të diskutohen vlerat natyrore të identifikuara si dhe masat që duhen marrë për adresimin e presioneve dhe kërcënimeve ndaj këtyre vlerave natyrore. Një sesion specifik do t'i kushtohet mundësive të financimit lidhur me Natura 2000.

Pjesëmarrësve do tu shpjegohet dhe ilustron logjika e Qasjes Inovative Bazuar në Ekosistemin duke përkrahur me hollësi të gjitha hapat që do të ndërmerren gjatë procesit. Takimet e ndryshme do të shërbejnë edhe për zgjerimin e listës së palëve të interesuara dhe rolin/angazhimit të tyre në përcaktimin dhe menaxhimin e zonave të propozuara Natura 2000.

## 3 Analiza e rezultateve

### 3.1 Përshkrimi i zonës

Në vitin 2005, mbështetur në rekomandimet e disa studimeve të kryera për zonën, të cilët vlerësuan karakteristikat dhe veçoritë specifike të Liqenit të Shkodrës si liqeni më i madh tektonik-karstik ndërkufitar, me bimësi të zhvilluar dhe me biodiversitet të lartë, u miratua shpallja e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës” si zonë e mbrojtur e kategorisë IV sipas IUCN.


Liqeni i Shkodrës karakterizohet nga një diversitet i lartë i habitateve, me shumë burime karstike dhe me një bimësi të zhvilluar submerse, flotuese, emerse dhe me pak pyje ripariene/aluvionale. Liqeni shërben si një vend strehimi për shumë specie shpendësh dimëruese dhe vend ushqimi dhe folezimi për shumë specie shpendësh të kërcënuar, si dhe është një vend ushqimi dhe riprodhimi për shumë specie peshqish liqenor dhe migrues.

Liqeni i Shkodrës shtihet tërësisht në qarkun Shkodër dhe ndahet midis Bashkive Shkodër dhe Malësia e Madhe. Liqeni është pjesë e rrjetit EMERALD, zonë RAMSAR, IBA (Zonë e rëndësishme për shpendët) dhe IPA (Zonë e rëndësishme për bimët).

Me Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 60, datë 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar apo Park Natyror (kategoria IV) të zonave të mbrojtura mjedisore”, sipërfaqja e përgjithshme e zonës së mbrojtur RNM/Parku Natyror “Liqeni i Shkodrës” është ha. Sipërfaqja e RNM Liqeni i Shkodrës përbëhet kryesisht nga mjedisë ujore (15719 ha; xx%); pyje e shkurre (1965 ha; xx%) e mjedisë të tjera (8851 ha; xx%).

Liqeni administrohet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), nëpërmjet Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura të Qarku Shkodër (ARZM). Zona e mbrojtur paraqitet pjesërisht i dëmtuar nga peshkimi intensivë, gjuetia ilegale, zhvillimi i turizmit, futja e llojeve jo-vendase dhe nga keq menaxhimi.





**FIGURA 1. HARTA E ZONAVE TË MENAXHIMIT TË RNM LIQENI I SHKODRËS**

Liqeni i Shkodrës ndahet në tre zona menaxhimit të ndryshme: Zonë Qendrore (1/a) me mbrojtje të nivelit 1 (shënuar me vija jeshile në hartë), Zonë e Menaxhimit të Habitaveve (2/a) me mbrojtje të nivelit 2 (shënuar me vija të verdha në hartë), Zona e Zhvillimit Tradicional (3) me mbrojtje të nivelit 4 (shënuar me pika vjollcë në hartë) (Fig. 1).

Në rastin e analizës për Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës, zona e studimit përputhet plotësisht me kufirin e zonës së mbrojtur. Më poshtë paraqitet kufiri i zonës dhe rrjeti kuadratik me kuadrate 1 km<sup>2</sup> që do të përdoret për analizimin e të dhënave. Rrjeti kuadratik përfshin gjithsej 300 kuadrate, çka do të thotë që sipërfaqja totale e analizuar është 300 km<sup>2</sup> (30,000 ha), diçka më e madhe se sipërfaqja e përgjithshme e parkut kombëtar, për arsye si kufiri i parkut kalon përmes një numri kuadratesh.



**FIGURA 2. HARTA BAZE – KUFIRI I PARKUT DHE RRJETI KUADRATIK**

## 3.2 Vlerat Natyrore

### 3.2.1 Mbulesa e tokës

Harta e mbulesës së tokës për Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës është realizuar bazuar në të dhënat e Hartës së Mbulesës së Tokës për Shqipërinë<sup>2</sup>, viti 2018, hartuar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit me ndihmën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë dhe administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).

<sup>2</sup> [https://geoportal.asig.gov.al/map/?fc\\_name=Mbulesa\\_tokes\\_Corine\\_2018](https://geoportal.asig.gov.al/map/?fc_name=Mbulesa_tokes_Corine_2018)




Sipas sistemit të klasifikimit CORINE, mbulesa e tokës në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës dominohet nga sipërfaqja ujore e pasqyrës së liqenit (58%). Në territorin e parkut përfshihen edhe sipërfaqe artificiale (3%) (zona urbane e industriale, komerciale) dhe mjedise bujqësore (21%), ku përfshihen edhe disa sipërfaqet të vogla kullosore. Pyjet dhe zonat gjysmë natyrore zënë vetëm 14% të sipërfaqes, përfaqësuar kryesisht nga Vegjetacion shkurre e barishtor (10%). Gjithashtu, në territorin e parkut ka edhe disa terrene me pak ose aspak bimësi, kryesisht sipërfaqe shkëmbore e zona me bimësi të rrallë.

**TABELA 1: MBULESA E TOKËS SIPAS CORINE 2018**

Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Kodi	Rëndësia	SIP (ha)	% SIP
<b>Sipërfaqe artificiale</b>					<b>892.86</b>	<b>3.0%</b>
	<i>Zona urbane</i>				<b>851.62</b>	<b>2.8%</b>
		Zona urbane të ndërprera	112	1	851.62	2.8%
	<i>Zona industriale, komerciale dhe transporti</i>				<b>14.82</b>	<b>0.0%</b>
		Zona industriale dhe komerciale	121	1	14.82	0.0%
	<i>Sipërfaqe artificiale, me vegjetacion jo bujqësor</i>				<b>26.11</b>	<b>0.1%</b>
		Terrene sportive e rekreative	142	1	26.11	0.1%
<b>Sipërfaqe bujqësore</b>					<b>6,379.52</b>	<b>21.3%</b>
	<i>Toka bujqësore</i>				<b>3,329.52</b>	<b>11.1%</b>
		Toka bujqësore të pa ujitura	211	1	3,329.52	11.1%
	<i>Kullota</i>				<b>704.73</b>	<b>2.3%</b>
		Kullota	231	3	704.73	2.3%
	<i>Toka bujqësore të përziera</i>				<b>2,345.27</b>	<b>7.8%</b>
		Zona bujqësore komplekse	242	1	1,982.39	6.6%
		Toka të ish bujqësore me prani të lartë të vegjetacionit natyror	243	2	362.88	1.2%
<b>Pyje e zona gjysmë natyrore</b>					<b>4,301.04</b>	<b>14.3%</b>
	<i>Pyje</i>				<b>306.82</b>	<b>1.0%</b>
		Pyje fletorë	311	3	159.54	0.5%
		Pyje halorë	312	3	147.28	0.5%
	<i>Vegjetacion shkurre-barishtor</i>				<b>3,077.96</b>	<b>10.3%</b>
		Livadhe natyrore	321	3	1,392.13	4.6%
		Vegjetacion sklerofil	323	2	1,296.20	4.3%
		Zonë e ndërmjetme pyll-shkurre	324	1	389.63	1.3%
	<i>Zona të hapura me pak ose aspak bimësi</i>				<b>916.26</b>	<b>3.0%</b>
		Plazhe duna ranore	331	2	125.05	0.4%
		Zona me bimësi të rrallë	333	1	791.22	2.6%
<b>Ligatina</b>					<b>902.30</b>	<b>3.0%</b>
	<i>Ligatina të brendshme</i>				<b>902.30</b>	<b>3.0%</b>
		Moçale të brendshme	411	3	902.30	3.0%
<b>Trupa ujorë</b>					<b>17,513.41</b>	<b>58.4%</b>
	<i>Ujëra të brendshme</i>				<b>17,513.41</b>	<b>58.4%</b>
		Rrjedha ujore	511	2	20.66	0.1%
		Trupa ujorë	512	2	17,492.75	58.3%
<b>TOTALI</b>					<b>29,988.83</b>	<b>100.0%</b>





**FIGURA 3. HARTA E MBULESËS SE TOKËS (CORINE 2018)**

Mbi bazën e hartës së mbulesës së tokës është realizuar harta e vlerës së mbulesës së tokës, e cila tregon zonat më me vlerë brenda parkut për sa i përket tipit të mbulesës së tokës në një rezolucion 1 km<sup>2</sup> (rrjeti kuadratik). Tipet e mbulesës së tokës janë klasifikuar në një shkallë nga 1 (pak i

rëndësishëm) në 3 (shumë i rëndësishëm). Për secilin kuadrat të rrjetit kuadratik është llogaritur sipërfaqja që zë çdo tip klasifikimi dhe kjo është shumëzuar me vlerën përkatëse të rëndësisë.




FIGURA 4. HARTA E VLERËS SË MBULESËS SË TOKËS (CORINE 2018)

Shuma e vlerave për secilin kuadrat jep vlerën nominale të kuadratit. Vlerat nominale janë normalizuar sipas formulës  $x_{i\text{Normal}} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks<sup>3</sup>, 1967), i cili përpiket të gjejë grupime natyrore të të dhënave për të krijuar klasat. Klasat që rezultojnë kanë variacion maksimal midis klasave individuale dhe më pak variacion brenda çdo klase. Në rastin e mbulesës së tokës klasat janë ndarë si më poshtë:

- Klasa 1 – Pak e Rëndësishme – Vlerat 0.000000 - 0.511660
- Klasa 2 – Mesatarisht e Rëndësishme – Vlerat 0.511661 - 0.804792
- Klasa 3 – Shumë e Rëndësishme – Vlerat 0.804793 - 1.000000

### 3.2.2 Vegjetacioni dhe habitatet kryesore N2000

Parku Natyror Liqeni i Shkodrës popullohet nga një larmi tipash vegjetacioni e habitatesh natyrore, që përmbajnë lloje bimore me rëndësi të veçantë ruajtjeje, të rralla e të kërcënuara, etj. Bazuar në studimet paraprake në parkun natyror Liqeni i Shkodrës gjenden 29 tipe vegjetacioni. Ndër tipet e rëndësishme të vegjetacionit përmendim ato të gjendura në mjedise natyrore si pyje e kullota edhe pse nuk zënë ndonjë sipërfaqe të konsiderueshme.

**TABELA 2: LISTA E TIPAVE TË VEGJETACIONIT NË PARKUN NATYROR LIQENI I SHKODRËS**

Tipet e vegjetacionit	Rëndësia	SIP (ha)	% Sip
<b>Terrene jo natyrore</b>		<b>4,298.67</b>	<b>16.58%</b>
Zona të urbane të pandërprera	1	13.79	0.05%
Zona urbane të ndërprera	1	169.25	0.65%
Sipërfaqe bujqësore të përziera	1	2,933.53	11.32%
Njësi industriale apo komerciale	1	9.05	0.03%
Gurore	1	13.79	0.05%
Rruge dhe hekurudha	1	12.06	0.05%
Shtëpi rurale	1	1,143.64	4.41%
Zona me interes arkeologjik	3	3.56	0.01%
<b>Terrene kullosore</b>		<b>3,010.29</b>	<b>11.61%</b>
Kullota e djerrina	2	2,351.56	9.07%
Mozaik komunitetesh shkurrore e barishtore	3	274.44	1.06%
Kullota shkembore	2	384.30	1.48%
<b>Terrene ligatinore</b>		<b>732.35</b>	<b>2.83%</b>
Kallamishte në ujëra pothuasje të qeta	2	66.39	0.26%
Mozaik ligatinash me komunitete hidrofite	3	167.97	0.65%
Mozaik komunitetesh ligatinore	3	85.61	0.33%
Kullota me copëza vegjetacioni ligatinor të degraduar në pjesë aluvionale	2	371.11	1.43%
Kallamishte dhe xunkthe në ujëra të thella të qeta	2	41.27	0.16%
<b>Sipërfaqe pyjore</b>		<b>2,313.52</b>	<b>8.93%</b>
Pyje aluvionale	3	260.74	1.01%

<sup>3</sup> Jenks G. (1967) Koncepti i modelit të të dhënave në hartografinë statistikore. Libri vjetor ndërkombëtar i hartografisë 7: 186-190.



Cungishte me shkoze dhe frasher (sibljak)	2	926.53	3.57%
Pyje halore	3	11.25	0.04%
Shkuretta mesdhetare sklerofile me Fraxino omi-Cotinetalia (sibljak)	2	361.08	1.39%
Pyje me shkoze dhe dushqe të përzier	2	562.94	2.17%
Mozaik pyjesh dhe ligatinash	3	134.43	0.52%
Pyje aluvionale dominuar nga Alnus glutinosa, Fraxinus angustifolia apo Quercus robur	3	20.79	0.08%
Pyje aluvionale dominuar nga Populus alba dhe Salix alba	3	35.76	0.14%
<b>Sipërfaqe ujore</b>		<b>15,384.12</b>	<b>59.35%</b>
Liqeni i Shkodrës	2	15,287.17	58.98%
Trupa ujqorë	2	64.06	0.25%
Përroi i Thate	2	32.89	0.13%
<b>Terrene të degraduara</b>		<b>181.95</b>	<b>0.70%</b>
Toka të zhveshura me vegetacion të degraduar	1	96.06	0.37%
Toka të zhveshura me vegetacion të rrallë shkëmbor	1	85.88	0.33%
<b>Totali</b>		<b>25,920.89</b>	<b>100.00%</b>

Edhe pse zënë vetëm 9% të sipërfaqes së zonës së mbrojtur, zona dallohet për një larmi tipesh vegetacioni pyjor që përfshin pyje me shkozë e dushqe si dhe variacione të pyjeve aluvionale me vërrin, frashër, plep e shelgje. Me interes janë edhe variantet e ndryshme të vegetacionit ligatinor të brigjeve të liqenit, të cilat përfshijnë lloje të ndryshme kallamishtesh dhe bimësh të tjera që ndikohen nga prania e ujit.

Mbi bazën e hartës së tipave të vegetacionit është realizuar harta e vlerës së vegetacionit, e cila tregon zonat më me vlerë brenda parkut për sa i përket tipit të vegetacionit në një rezolucion 1 km<sup>2</sup> (rrjeti kuadratik). Tipet e vegetacionit janë klasifikuar në një shkallë nga 1 (pak i rëndësishëm) në 3 (shumë i rëndësishëm). Për secilin kuadrat të rrjetit kuadratik është llogaritur sipërfaqja që zë çdo tip vegetacioni dhe kjo është shumëzuar me vlerën përkatëse të rëndësisë. Shuma e vlerave për secilin kuadrat jep vlerën nominale të kuadratit. Vlerat nominale janë normalizuar sipas formulës  $x_i \text{ Normal} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks, 1967), i cili përpiket të gjejë grupime natyrore të të dhënave për të krijuar klasat. Klasat që rezultojnë kanë variacion maksimal midis klasave individuale dhe më pak variacion brenda çdo klase. Në rastin e tipave të vegetacionit klasat janë ndarë si më poshtë:

- Klasa 1 – Pak e Rëndësishme – Vlerat 0.000000 - 0.3625
- Klasa 2 – Mesatarisht e Rëndësishme – Vlerat 0.3626 - 0.7505
- Klasa 3 – Shumë e Rëndësishme – Vlerat 0.7506 - 1.0000





FIGURA 5. HARTA E TIPAVE TË VEGJETACIONIT



**FIGURA 6. HARTA E VLERËS SË TIPAVE TË VEGJETACIONIT**

Identifikimi dhe analiza e tipit të habitateve më të rëndësishme për RNM Liqeni i Shkodrës është bërë duke u bazuar në listën e habitateve të Aneksit I, të Direktivës së Habiteteve. Ekspertët kanë identifikuar 8 habitate të rëndësishme, të cilat kanë nevojë për ruajtje strikte, ku përfshihen 4 habitate ujore, 3 habitate ligatinore dhe 1 habitat tokësor.



---

Projekti NaturaI (Strengthening capacity in National Nature Protection preparation for Natura 2000 network) ka hartografuar 6 habitate në pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës, përkatësisht habitatet 3150, 3260, 91F0, 92A0, 92D0 dhe 91A0. Ndërkohë, ekspertët vlerësojnë se në RNM Liqeni i Shkodrës ndodhen edhe tre tipe të tjera habitatesh, përveç atyre të përcaktuara nga De Santis (2016-17) në kuadër të projektit NaturaI, përkatësisht habitatet 62A0\*, 3130 dhe 3140.

Gjithashtu, ekspertët vlerësojnë se në RNM Liqeni i Shkodrës nuk ndodhet Habitati prioritar 91E0 - \*Pyll aluvional me *Alnus glutinosa* dhe *Fraxinus excelsior* (*Alno-Padion*, *Alnion incanae*, *Salicion albae*), megjithëse është identifikuar në pjesën shqiptare të Liqenit nga ekspertët e projektit NaturaI. Sipas “Manual of European Union habitats” ky tip habitati nuk është i pranishëm në zonën nënmesdhetare, d.m.th. që në të gjitha pyjet bregore të Mesdheut dhe Nënmesdheut, në të cilët dominojnë shelgjet e larta (*Salix alba*, *S. fragilis*) dhe plepat (*Populus alba*, *P. nigra*), duhet të klasifikohen si tipi 92A0.

Përfundimisht, lista e habitateve të rëndësishme, sipas Direktivës së Habitaveve, të identifikuara në RNM Liqeni i Shkodrës është si vijon:


- 3130 - Ujëra të palëvizshme oligotrofike deri mesotrofike me vegjetacion të klasës Littorelletea uniflorae dhe/ose të dhe/ose të *Ludwigietum palustris*;
- 3140 - Habitata ujrash të forta oligo-mesotrofike të karakterizuara nga vegjetacioni benthik i *Chara* spp.
- 3150 - Liqene natyrore eutrofikë të karakterizuara nga tipa vegjetacioni të aleancave *Magnopotamion* ose *Hydrocharition*;
- 3260 - Rrjedhje ujore në ultësira deri në zonat malore me vegjetacion të aleancave *Ranunculion fluitantis* dhe *Callitriche-Batrachion*/si *Batrachietum trichophylli* Soo (1927) 1970.
- 91F0 - Pyje të përzier riparianë të *Quercus robur*, *Ulmus laevis* dhe *Ulmus minor*, *Fraxinus excelsior* ose *Fraxinus angustifolia*, përgjatë lumenjve të mëdhenj (*Ulmenion minoris*);
- 92A0 - Galeri apo breza pyjore me *Salix alba* dhe *Populus alba*;
- 92D0 - Galeri apo breza shkurre ripariane Jugore (*Nerio-Tamaricetea* dhe *Securinegion tinctoriae*);
- 62A0(\*) - Kullota të thata sub – Mesdhetare Lindore (*Scorzoneratalia villosae*) (habitat prioritar)

Megjithatë, për habitatet natyrore të listuara si të pranishme në këtë zonë nevojitet rishikimi i tyre, dhe jo vetëm por edhe i vegjetacionit përkatës. Gjithashtu nevojitet rishikim i sipërfaqes që ato përfshijnë, vlerësim i gjendjes aktuale dhe ngritja e të dhënave të vazhdueshme me bazë përditësimin e tyre nga zbatimi i veprimeve menaxhuese e protokolleve monitoruese.

Përveç habitateve me rëndësi për komunitetin Evropian, të listuar më sipër, Parku Natyror Liqeni i Shkodrës përfshin edhe një sërë territoresh që janë thelbësore për mbijetesën e disa llojeve të rëndësishme të peshqve por jo vetëm.


<b>Zona me rëndësi</b>	<b>Sip. (ha)</b>
Zona ku shumohet Gjuca	429.02
Zona ku shumohet Krapa	184.46
Zona ku shumohet Kubla	1,381.75
Bimësi Makrofitë	125.68
Zona ku shumohet Njila	437.04

Mbi bazën e hartës së tipave të habitateve dhe zonave me rëndësi është realizuar harta e vlerës së habitateve, e cila tregon zonat me habitate të rëndësishme brenda parkut në një rezolucion 1 km<sup>2</sup> (rrjeti kuadratik). Për habitatet është vlerësuar që prania e një habitati të rëndësishëm është vlerë e mjaftueshme. Kështu, klasifikimi është bërë në një shkallë 0 (jo i pranishëm) dhe 1 (i pranishëm).



**FIGURA 7. HARTA E HABITATEVE KRYESORE TË PARKUT**

Për secilin kuadrat të rrjetit kuadratik është llogaritur sipërfaqja që zë çdo tip habitati. Shuma e vlerave për secilin kuadrat jep vlerën nominale të kuadratit. Vlerat nominale janë normalizuar sipas formulës  $x_i \text{ Normal} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks, 1967).




**FIGURA 8. HARTA E VLERËS SE HABITATEVE DHE ZONAVE TË RËNDËSISHME**



Në rastin e tipave të habitatit klasat janë ndarë si më poshtë:

- Klasa 1 – Pak e Rëndësishme – Vlerat 0.0000 - 0.2500
- Klasa 2 – Mesatarisht e Rëndësishme – Vlerat 0.2501 - 0.7500
- Klasa 3 – Shumë e Rëndësishme – Vlerat 0.7501 - 1.0000



**FIGURA 9. HARTA E VLERËS SE HABITATEVE DHE ZONAVE TË RËNDËSISHME**

### 3.2.3 Lloje të rëndësishme të florës

Për identifikimin e llojeve të florës të pranishme në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës janë shfrytëzuar të dhënat e grumbulluara nga ekspertë të ndryshëm, si dhe ato të grumbulluara dhe regjistruara nga eksperti lokal Prof. Dr. Marash Rakaj, gjatë realizimit të studimit të vlerave të parkut në kuadër të këtij projekti.

Në RNM Liqeni i Shkodrës kemi evidentuar 16 specie bimësh (1 lloj Pteridophyta ose fier dhe 15 lloje Angjiosperma, ose bimë me lule), prej të cilave 4 lloje subendemike; 1 endemike Ballkanike; 4 lloje të listuar në Aneksin II, 3 lloje në Aneksin IV dhe 2 lloje në Aneksin V të Direktivës së Habitave, 7 lloje të listuar në Aneksi I të Konventës së Bernës për ruajtjen e llojeve me rëndësi për Evropën, si dhe 13 lloje të listuara në Listën e Kuqe të IUCN.

**TABELA 3: LISTA E LLOJEVE TË BIMËVE TË RËNDËSISHME NË PARKUN NATYROR LIQENI I SHKODRËS**

Nr.	Emri shkencor i species	Emri shqip i species	Ende mike	Direk. Habitateve	Konv. Bernës	Lista e Kuqe IUCN
1	<i>Marsilea quadrifolia</i>	Marsili katërgjethëshe		II, IV	+	NT
2	<i>Anacamptis pyramidalis</i>	Anakampte piramidore		II, IV	+	LC
3	<i>Caldesia parnassifolia</i>	Kaldese gjetheparnasi		II, IV	+	NT
4	<i>Campanula austroadriatica</i>	Lulekambanë e Adriatikut	SubE*			NE
5	<i>Cymbalaria ebelii</i>	Cimbalare e Ebelit	SubE*			NE
6	<i>Galanthus nivalis</i>	Boçëborë		V		NT
7	<i>Gladiolus palustris</i>	Gladiolël kënetash				DD
8	<i>Hyacinthella dalmatica</i>	Zymbyli dalmat	SubE*			NT
9	<i>Lindernia procumbens</i>	Linderne zvarritëse		II, IV		LC
10	<i>Ophrys apifera</i> ( <i>O. oestrifera</i> )	Ofris, Salep si bletë			+	LC
11	<i>Orchis provincialis</i> ( <i>pauciflora</i> )	Salep povincial			+	LC
12	<i>Petteria ramentacea</i>	Grill i degëzuar	EB**			NE
13	<i>Ruscus aculeatus</i>	Rrushkull gjembor		V		LC
14	<i>Tanacetum cinerariifolium</i>	Barpleshti (Karajpel)	SubE*			LC
15	<i>Trapa natans</i>	Kacirom, Arrë uji			+	NT
16	<i>Typha shuttleworthii</i>	Shavar i Shitleurtit			+	DD

\* Sub Endemike; \*\*Endemike për Ballkanin;

Shumica e 5 llojeve subendemike dhe ballkanike takohen në habitatet tokësore, kryesisht gurishtore e shkëmbore, të shtrira në bregun perëndimor të Liqenit (Tarabosh Shirokë-Zogaj; Habitat 62A0), dhe vetëm një lloj takohet në bregun veri-lindor (Kodrat e Moksetit ose Gashaj-Hot). Bimësia dominohet nga drurë dhe shkurre mezo- e kserofite përherë e gjelbërt, si ulliri (*Olea europaea*) dhe krifshë (*Phillyrea latifolia*), dhe drurë e shkurre gjetherënëse të degraduara (garrigue), me pak drurë të rrallë bulgëri (*Quercus trojana*), rrënje (*Quercus robur*) dhe frashër i bardhë (*Fraxinus ornus*) dhe shkurre, si shkoza (*Carpinus orientalis*), shega (*Punica granatum*), thanukla (*Cornus sanguinea*), driza (*Paliurus spina-christi*), murrizi (*Crataegus monogyna*), manaferra (*Rubus ulmifolius* etj., dhe një bimësi barishtore, e cila zhvillohet në pranverë dhe pastaj më pak në vjeshtë.

Po kështu, në habitate të ngjashme tokësore (Habitati 62A0) takohen edhe 5 speciet e listuara në Aneksin II, IV dhe V të Direktivës së Habitaveve, dhe në Aneksin I të Konventës së Bernës. Ndërsa 6 speciet e tjera të listuara në Aneksin II, IV dhe V të Direktivës së Habitaveve, dhe në Aneksin I të Konventës së Bernës takohen në habitate kënetore (palustrine, Habitati 92A0, 92D0) të dominuara nga bimësi emergjente, si *Phragmites communis*, *Schoenoplectus lacustris*, *Typha latifolia* etj., dhe habitate ujore liqenore (lacustrine, Habitati 3130, 3150), të dominuar nga bimësi ujore submerse dhe flotuese, si *Valisneria spiralis*, *Najas minor*, *Potamogeton spp.*, *Nuphar lutea*, *Nymphaea alba*, të shtrira kryesisht në bregun lindor të Liqenit.

Me gjithë njohuritë dhe informacionet e mësipërme, për fat të keq, për zonën e Liqenit të Shkodrës nuk kemi asnjë të dhënë të gjeoreferencuar mbi përhapjen e llojeve të rëndësishme të florës. Në këtë kuadër nuk kemi mundësi të përcaktojmë në hartë zonat e rëndësishme për florën, ndaj nuk kemi një hartë të zonave të rëndësishme për florën.

### 3.2.4 Lloje të rëndësishme të faunës

Si rezultat i larmisë së tipave të ndryshme të habitaveve natyrore, variacionit të lartësive mbi nivelin e detit dhe kushteve të tjera të favorshme, parku strehon një faunë me larmi të lartë llojesh, nga të cilat shumë

Pasuria faunistike e Parkut Natyror Liqeni i Shkodrës numëron 277 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme, dominuar nga shpendët, që pwrbwjnw mw shumë se gjysmwn e llojeve tw hasura (168). Njw numwr i madh llojesh paraqesin interes të veçantë ruajtje dhe përfshihen në Shtojcën II të Konventës së Bernës, në aneksin II dhe IV të Direktivës së Habitaveve, në Librin e Kuq të faunës shqiptare dhe të IUCN. Të paktën 43 specie janë endemike dhe subendemike të Shqipërisë, ose të Ballkanit Perëndimor,

Nga 277 specie të listuara në Listën e Kuqe të IUCN, 33 specie janë të kërcënuara globalisht: 1 specie e Zhdukur (EX), 5 specie të Rrezikuara seriozisht (CR), 13 specie të Rrezikuara (EN) dhe 14 specie të Cënuara (VU), ndërsa 16 specie rezultojnë afër kërcënimit (NT) (Tab. 3,4, Aneksi II).

**TABELA 4. LLOJE TË FAUNËS SIPAS GRUPEVE KRYESORE QË HASEN NË PARKUN NATYROR LIQENI I SHKODRËS**

Grupet kryesore	Lloje gjithsej	Endemike	Direktiva e Habitaveve (anekse)			Konventa Bernës
			II	IV	V	
Invertebrtorë	32	24	7	5	2	0
Peshq	24	17	4	3	3	2
Amfibë	7	2	1	5	1	4
Zvarranikë	19	0	4	19	0	19
Gjitarë	27	0	12	25	2	21
Shpendë	168	0	0	0	0	168
<b>Gjithsej</b>	<b>277</b>	<b>43</b>	<b>28</b>	<b>56</b>	<b>8</b>	<b>213</b>

**TABELA 5. LLOJE TË FAUNËS SIPAS KATEGORIVE TË RREZIKIMIT SIPAS LISTËS SË KUQE TË IUCN**

Kategoritë e rrezikimit	Grupet Taksonomike						Gjithsej
	Invertebrorë	Peshq	Amfibë	Zvarranikë	Gjitarë	Shpendë	
Të zhdukura (EX)	0	1	0	0	0	0	<b>1</b>



<b>Të rrezikuara seriozisht (CR)</b>	2	3	0	0	0	0	<b>5</b>
<b>Të rrezikuara (EN)</b>	6	1	1	0	0	5	<b>13</b>
<b>Të për-keqësuara (VU)</b>	3	3	0	0	3	5	<b>14</b>
<b>Pothuajse të rrezikuara (NT)</b>	3	0	0	4	5	7	<b>19</b>
<b>Pak të shqetësuara (LC)</b>	1	13	6	15	19	148	<b>202</b>
<b>Të dhëna të pamjaftueshme (DD)</b>	3	2	0	0	0	0	<b>5</b>
<b>Të pa vlerësuara (NE)</b>	14	1	0	0	0	2	<b>17</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>32</b>	<b>24</b>	<b>7</b>	<b>19</b>	<b>27</b>	<b>168</b>	<b>277</b>

Në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës hasen 32 lloje invertebrorësh (17 molusqe gastropodë, 10 gaforre, 5 insekte) të listuar në anekset e Direktivave Evropiane për mbrojtjen e natyrës. Të paktën 24 lloje invertebrore (16 molusqe dhe 8 gaforre) janë endemike të Liqenit të Shkodrës, ose të rrjetit hidrologjik Liqeni i Shkodrës - Lumi Drin-Liqeni i Ohrit. Shumica e specieve endemike të molusqeve Gastropoda janë gjetur në burimet sublakustrine (Syri i Virit, Syri i Sheganit, Hordhana) në ujërat nëntokësore të Liqenit të Shkodrës dhe habitatet ujore përreth tij (Dobraç, Lumenjtë Buna, Moraça e Crnojevica). 11 lloje invertebrorësh janë të kërcënuar globalisht:

Studiuesit vlerësojnë se 17 lloje peshqish të hasur në zonë janë endemike të Liqenit të Shkodrës, të Shqipërisë, ose të ujërave të Ballkanit Perëndimor (pellgut të Adriatikut dhe Jonit). Me rëndësi më të madhe janë 2 lloje prioritare (\**Acipenser naccarii* dhe \**Acipenser sturio*). Gjithashtu, 24 specie janë të listuara në Listën e Kuqe të IUCN, prej të cilëve 9 specie janë të kërcënuar globalisht, 1 specie e Zhdukur (*Chondrostoma scodrense*), 3 specie të rrezikuara seriozisht (*Acipenser naccarii*, *Acipenser sturio* dhe *Anguilla anguilla*).

Në Liqeni e Shkodrës tradicionalisht janë zënë gjuca (*Alburnus scoranza*), krapa (*Cyprinus carpio*), njila (*Chondrostoma nasus*), kubla (*Alosa agone*), ngjala (*Anguilla anguilla*), qefujt (*Mugil cephalus*, *Liza ramada*), levreku (*Dicentrarchus labrax*), troftat (*Salmo*), mëlyshi (*Leuciscus cephalus*), lloska (*Scardinius knezevici*), blinët (*Acipenser sturio*, *Acipenser naccarii*) skortat (*Rutilus*), *Pachychilon pictum*), shojza (*Platichthys flesus*), të cilët konsiderohen edhe peshq të tregut (Dhora 2016).

Nga llojet e introduktuara në liqen për peshkim, vetëm karasi i artë (*Carassius gibelio*) është përshtatur krejtësisht për jetesë në këtë liqen. Vitet e fundit vihet re edhe shtimi i sharmakut (*Perca fluviatilis*) në Liqen, e cila ka hyrë prej dy dekadash përmes Lumit Drin. Sipas Dhora (2016), menaxhimi i peshqve të liqenit duhet të marrin në konsideratë të paktën dy çështje të rëndësishme:

- Së pari, duhet kushtuar kujdes më i madh me speciet piscivore migruese për në det. Për këtë është e nevojshme të monitorohet mbyllja dhe hapja e Dajlanit mbi Lumin Buna, duke u kujdesur për hyrjet e ngjalës, (*Anguilla anguilla*) dhe kublës (*Alosa agone*), si dhe i peshqve të tjerë në liqen.

- Së dyti, duhet te monitorohet popullata e sharmkut (*Perca fluviatilis*) në liqen, si dhe zënia e kësaj specie. Tanimë kjo specie është shtuar në liqen dhe është ndër peshqit kryesorë të tregut.

Në habitatet ujore dhe ligatinore të Liqenit të Shkodrës hasen 7 lloje të amfibëve (5 bretkosa dhe 2 thithlopa) të listuara në Aneksët e Direktivave Evropiane për mbrojtjen e natyrës. 2 lloje janë endemike, dhe 1 lloj i rrezikuar globalisht (*Pelophylax shqipericica*)

Në habitatet ujore e tokësore të Parkut Natyror Liqeni i Shkodrës dhe pellgut ujëmbledhës të tij hasen 19 lloje zvarranikësh të listuar në Aneksët e Direktivave Evropiane për mbrojtjen e natyrës. Në Listën e Kuqe të IUCN janë listuar 4 specie pothuajse të rrezikuara (2 breshka: *Emys orbicularis* dhe *Mauremys rivulata* dhe 2 gjarprinj: *Coluber laurenti (gemonensis)* dhe *Elaphe quatuorlineata*).

Në zonë e Liqenit të Shkodrës hasen edhe një numër gjitarësh (28) të listuar në anekset e Direktivave Evropiane për mbrojtjen e natyrës, përfshirë 2 lloje prioritare si ariu (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*), apo edhe një lloj karizmatik si lundërza (*Lutra lutra*). Zona është e rëndësishme edhe për disa lloje të rëndësishëm të lakuriqëve të natës të listuar në Listën e Kuqe të IUCN.

Liqeni i Shkodrës konsiderohet ndër 4-5 ligatinat më të rëndësishme për dimërimin e shpendëve në Evropë, megjithëse vërehet një rënie e tyre gjatë dekadës së fundit. Rreth 60% e specieve janë dimëruese, ndërsa shumica e tyre janë migruese, ose endacake, në pranverë dhe vjeshtë. Gjithashtu, mendohet se mbi 55% e specieve të identifikuara janë folenizuese të zakonshëm, ose të rrallë, prej të cilëve 17 % janë shpend ujqor, por që shumica e tyre folenizojnë në pjesën malazeze të Liqenit, përfshij specien globalisht e rrezikuar, pelikanin kaçurrel (*Pelecanus crispus*), lloj globalisht i rrezikuar (50 çifte folezuese në Liqen). Në Liqen folenizojnë edhe *Aythya ferina*, *Ardeola ralloides*, *Fulica atra*, *Gallinula chloropus*, *Rallus aquaticus*, etj. (Dhora 2016).

Vitet e fundit vërehet që ka një rënie të numrit të shpendëve ujqor, veçanërisht të shpendë ujqor peshkngrënës, ndoshta për shkak të rënies të popullatave të peshkut. Një rënie e konsiderueshme në Liqen dhe në shkallë globale vërehet tek çafkat, rosat dhe tek patat. Kjo dukuri ka lidhje me shumë faktorë lokal, si gjuetia, rritja e nivelit të ndotjes, menaxhimi jo i mirë dhe me faktorë rajonal apo global, si p.sh., ndryshimet klimatike.

Për të analizuar rëndësinë e Liqenit të Shkodrës lidhur me llojet e faunës janë shfrytëzuar të dhënat e grumbulluara nga ekspertë të ndryshëm të regjistruara në bazën e të dhënave BIONNA, të dhënat e grumbulluara nga administrata e zonave të mbrojtura, të regjistruara në sistemin WiMS, si dhe ato të grumbulluara dhe regjistruara nga eksperti lokal Prof. Dr. Marash Rakaj, gjatë realizimit të studimit të vlerave të parkut në kuadër të këtij projekti.

**TABELA 6. LLOJE TË FAUNËS SIPAS GRUPEVE KRYESORE TË VROJTUARA NË PARKUN NATYROR LIQENI I SHKODRËS**

Grupet kryesore	Rende	Familje	Lloje	Direktiva Habiteteve	
				Aneks II	Aneks IV
Amfibë	1	3	6	0	3
Shpendë	15	34	86	25	0
Peshq	12	20	55	6	3
Insekte	1	1	1	0	0

<b>Gjitarë</b>	4	5	11	1	2
Zvarranikë	5	7	13	3	9
<b>Gjithsej</b>	38	70	172	35	17

Nga të dhënat e grumbulluara e të gjeo-referencuara rezultojnë gjithsej 1615 vrojtime të cilat kanë identifikuar 172 lloje të ndryshme kafshësh që i përkasin 6 grupeve kryesore, të ndara në 70 familje e 38 rende të ndryshme. Vendin kryesor e zënë shpendët dhe peshqit. 40 lloje janë të listuar në Listën e Kuqe të IUCN si të kërcënuar në shkallë të ndryshme.

**TABELA 7. LLOJE TË FAUNËS TË VROJTUARA SIPAS KATEGORIVE TË RREZIKIMIT SIPAS LISTËS SË KUQE TË IUCN**

Grupet kryesore	Të rrezikuara seriozisht	Të rrezikuara	Pak të shqetësuara	Pothuajse të rrezikuara	Të për-keqësuara	Gjithsej
<b>Amfibë</b>		1	2			3
Shpendë			17	3	1	21
Peshq	3		1			6
Insekte						0
Gjitarë			1	1		2
Zvarranikë			6	2		8
<b>Gjithsej</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>27</b>	<b>6</b>	<b>1</b>	<b>40</b>

Mbi bazën e hartës së shpërndarjes së llojeve të kafshëve është realizuar harta e vlerës së llojeve të faunës, e cila tregon zonat më me vlerë brenda parkut për sa i përket larmisë dhe rëndësisë së llojeve të kafshëve në një rezolucion 1 km<sup>2</sup> (rjeti kuadratik). Për të llogaritur vlerën e llojeve të kafshëve janë përdorur dy tregues të ndryshëm. Së pari, për secilin kuadrat, është vlerësuar pasuria llojore (i.e., numri i llojeve të identifikuara), bazuar në parimin që sa më i lartë numri i llojeve aq më i pasur dhe më i rëndësishëm është kuadrati. Së dyti, për çdo kuadrat është vlerësuar vlera e përgjithshme e vrojtimeve brenda kuadratis duke mbledhur vlerat e rëndësisë sipas llojeve (tabela me sipër) për secilin vrojtim. Vlera totale e kuadratis pjesëtohet me numrin e llojeve për secilin kuadrat për të dhënë vlerën nominale të rëndësisë.

Vlerat nominale të secilit tregues janë normalizuar sipas formulës  $x_{i \text{ Normal}} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Shuma e vlerave të normalizuara të secilit tregues jep vlerën nominale të kuadratis, e cila po ashtu është normalizuar sipas formulës së mësipërme. Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks, 1967), i cili përpiket të gjejë grupime natyrore të të dhënave për të krijuar klasat. Klasat që rezultojnë kanë variacion maksimal midis klasave individuale dhe më pak variacion brenda çdo klase. Në rastin e vlerës së llojeve të kafshëve klasat janë ndarë si më poshtë:

- Klasa 1 – Pak e Rëndësishme – Vlerat 0.0000 - 0.08728
- Klasa 2 – Mesatarisht e Rëndësishme – Vlerat 0.08729 - 0.267139
- Klasa 3 – Shumë e Rëndësishme – 0.267139 - 0.704126






FIGURA 10. HARTA E VROJTIMEVE TË LLOJEVE TË KAFSHËVE




FIGURA 11. HARTA E VLERËS SË LLOJEVE TË KAFSHËVE



---

### 3.2.5 Vlera kulturore

Shkodra është qyteti më i madh e më i rëndësishëm në bregun e Liqenit të Shkodrës, i cili përmendet për zakonet dhe traditat e lashta. Qyteti i Shkodrës u themelua që në shekullin e IV p. e. r. në kodrat përreth Kalasë Rozafa. Ai ishte qendra e fisit të Labeatëve, ndërsa gjatë mbretërimit të Gentit u bë qendra e shtetit ilir. Në shekullin e XVII e më pas u bë qendër e rëndësishme e krejt rajonit, me zhvillim të tregtisë, artizanatit etj. Përveç kalasë pranë qytetit gjenden Ura e Mesit dhe Xhamia e Plumbit, të dyja të gjysmës së dytë të shekullit XVIII, dhe jo larg prej saj kalatë e vjetra të Drishtit, Marshejit, Hotit, Moksetit, Samoborit, Grizhës. Shkodra përmban gjithashtu edhe vepra të tjera të rëndësishme me vlera historike, siç janë zonat arkeologjike dhe rrënoja e periudhës së Ilirëve në zonën e Koplikut, në pjesën lindore e Liqenit të Shkodrës, në Shirokë, në Pulaj, në rrjedhën e poshtme të Bunës.

Shkodra përfaqëson një nga qendrat kulturore më të hershme shqiptare. Që në shek. XI u përdor alfabeti latin. Me 1858 në Shkodër, dhe për herë të parë në Shqipëri, zbatohet arti i fotografimit. Fotografet Marubi i ka dhënë qytetit një fototekë unike në Shqipëri. Me 1870 krijohet shtypshkronja e pare nga etërit jezuitë. Pas kësaj funksionuan edhe shtypshkronja të tjera. Në fund të shek. XIX jezuitet, krijuan bandën e parë muzikore, ndërtuan stacionin e parë sinoptik, ngritën teatrin (me 1911 nis edhe shfaqja e filmit) gjithashtu edhe një shkollë piktore. Nga ky qytet do të ngrihen bazat e filozofisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe qytetarët e saj do të jenë ideatorët dhe nismëtarët e Lëvizjes Kulturore Shqiptare.

Në shumëllojshmërinë e elementëve përbërëse të kulturës, që i jep një stil unik veprimtarisë së saj është artizanati, i zhvilluar në drejtime të përpunimit të materialeve të ndryshme si: druri, metali, lëkura, me të cilët zakonisht punonin burrat, ndërsa gratë punonin kryesisht në qëndisjen e rrobave, çarçafëve, jastëkëve, mbulesave të tavolinave, në endjet e shumëllojshme të pëlhurës, në punimet e qilimave, hallive dhe të perdeve.

Kënga qytetare Shkodrane është pjesë e trashëgimisë shpirtërore. Kënga qytetare Shkodrane është një thesar me vlera artistike kombëtare. Repertori i saj është shumë i pasur dhe i larmishëm, e lindur në një ambient e në rrethana të caktuara historike. Lëvizja teatrore në Shkodër fillon nga fundi i shekullit XIX-të dhe u zhvillua kryesisht në shkolla dhe shoqëri fetare me vonë edhe laike. Teatri profesionist u krijua me 1949 mbi bazën e teatrit amator.

Në kuadër të identifikimit dhe vlerësimit të vlerave kulturore të zonës, ka qenë e vështirë të gjeo-referencohen elemente të veçanta apo objekte e zona të caktuara me vlera kulturore, historike e tradicionale. Për këtë arsye nuk kemi mundur të përgatisim një hartë të vlerës kulturore të zonës. Disa prej elementeve të përmendur më sipër janë evidentuar edhe si mbështetës të turizmit në zonë dhe për këtë arsye janë vlerësuar në kuadër të presionit turistik ndaj zonës.

### 3.2.6 Vlera natyrore

Vlera natyrore totale përmbledh gjithë vlerat e analizuar më sipër si vlera e mbulesës së tokës, e vegjetacionit, habitateve natyrore dhe e llojeve të kafshëve. Për secilin kuadrat të rrjetit kuadratik vlera totale llogaritet si shumatore e gjithë vlerave të përmendura më sipër. Rezultati final normalizohet sipas formulës  $x_i^{\text{Normal}} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks, 1967), i cili përpiket të gjejë grupime natyrore të të dhënave për të krijuar klasat. Klasat që rezultojnë kanë variacion maksimal midis klasave individuale dhe më pak variacion brenda çdo klase. Në rastin e vlerës totale natyrore klasat janë ndarë si më poshtë:



- Klasa 1 – Pak e Rëndësishme – Vlerat 0.0000 - 0.281605
- Klasa 2 – Mesatarisht e Rëndësishme – Vlerat 0.281606 - 0.524382
- Klasa 3 – Shumë e Rëndësishme – 0.524383 - 1.0000





FIGURA 12. HARTA E VLERËS TOTALE NATYRORE


Nga analiza e rezultateve tregon se vetëm një pjesë e vogël e territorit të zonës së mbrojtur (14%) vlerësohet si shumë e rëndësishme për ruajtjen e vlerave natyrore ndërkohë që pjesa më e madhe e territorit (59%) paraqitet si pak e rëndësishme për ruajtjen e vlerave natyrore.



**FIGURA 13. HARTA E VLERËS TOTALE NATYRORE KRAHASUAR ME ZONIMIN E PARKUT**



Është me interes të vërejmë se zonat e klasifikuara si shumë të rëndësishme, janë më të gjera se sipërfaqja e zonës qendrore të parkut natyror Liqeni i Shkodrës, çka do të thotë se zoonimi i parkut ka lënë jashtë zonës qendrore zona më rëndësi për ruajtjen e vlerave natyrore të kësaj zone të mbrojtur (shiko hartën e zonimit).



**FIGURA 14. SHPËRNDARJA E SIPËRFAQES SIPAS KLASAVE TË VLERËSIMIT TË VLERËS NATYRORE**

### 3.3 Presionet/Kërcënimet

Vlerësimi i kërcënimeve u realizua në bashkëpunim me palët e interesuara. Identifikimi dhe lidhja e kërcënimeve me vlerat është realizuar duke identifikuar përdoruesit, sjelljet e tyre dhe shkaqet kryesore të sjelljes. Identifikimi i shkaqeve kryesore të sjelljes është i nevojshëm për identifikimin e objektivave dhe veprimtarive të menaxhimit dhe ruajtjes së vlerave natyrore.

Liqeni Shkodrës është liqen i cektë dhe prandaj aktivitetet njerëzor ndikojnë direkt mbi situatën ekologjike dhe eutrofikimin e tij. Ndër faktorët kryesorë kërcënues për Liqenin e Shkodrës përmendim:

- Ndryshimet klimatike të shoqëruara me reshje të shumta në intervale kohe të shkurta, ose me thatësi të zgjatur;
- Luhatjet sezonale dhe vjetore të ujit në liqen, disa here të shoqëruara me përmytje të fshatrave dhe tokave të pjesës jugore të liqenit dhe përgjatë Lumit Buna;
- Erozioni i favorizuar nga terrenet gëlqerore të pjerrëta dhe shumë të pjerrëta dhe nga mbulesa bimore e varfër, ose e përkeqësuar;
- Shkarkimi i lëndëve toksike, si piralena, fenolet, hidroksidet e tjerë, veçanërisht të pranishme në fushat e Zetës, fushat e Mbishkodrës dhe në ujërat e zeza, që përmes zinxhirëve ushqimor merren nga njeriu dhe shkaktojnë sëmundje të sistemit skeletik, respirator, gjenital, endokrin etj;
- Eutrofikimi kultural i shkaktuar nga aktiviteti njerëzor (mbetjet e ngurta organike, ujërat e fermave bujqësore dhe blegtorale, ujërat urbane dhe ujërat e zeza të pasura me lëndë



---

ushqyese ose nutrientë, të cilat hyjnë liqen kryesisht përmes afluentëve dhe përmytjeve të Ultësirës Zeta-Shkodër etj.).

Ndikimi i këtyre faktorëve lidhet ngushtësisht me një sërë aktivitetesh socio-ekonomike të kryera nga komunitete të ndryshme që jetojnë përgjatë brigjeve të Liqenit të Shkodrës. Disa nga këto aktivitete, të analizuara më poshtë e të marra në konsideratë gjatë vlerësimit të kërcënimeve ndaj burimeve natyrore në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës, janë:

- Infrastruktura rrugore,
- Peshkimi i pa kontrolluar (përfshirë edhe aktivitete ilegale dhe peshkim me mjete shfarosëse),
- Dëmtimi i bimësisë së bregut nga kullotja intensive,
- Aktivitetet turistike,
- Zjarret.

### 3.3.1 Infrastruktura rrugore

Rrjeti rrugor është një mbështetës i zhvillimit të zonës pasi lehtëson aksesin dhe lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave. Pikërisht, për këtë qëllim, shtrirja dhe tipologjia e rrjetit rrugor mund të konsiderohet si kërcënim për vlerat natyrore. Rruga kombëtare Shkodër Hani i Hotit (43 km) shkon pothuajse paralel me kufirin lindor të Parkut Natyror Liqeni i Shkodrës. Ndërkohë që linja hekurudhore Shkodër-Bajzë-Hani i Hotit (39.55 km) përcakton në pjesën më të madhe kufirin lindor të parkut. Në brendësi të zonës së mbrojtur ka vetëm rrugë rajonale dytësore (60.5 km) dhe rrugë sezonale (9.7 km).

Për të vlerësuar efektin e rrugëve mbi vlerat natyrore të parkut kemi marrë një zonë buferike përgjatë gjithë gjatësisë së rrugëve që shtrihen brenda parkut. Gjerësia e zonës buferike ndryshon sipas kategorisë së rrugës, bazuar në parimin që sa më e mirë rruga aq më shumë akses siguron ajo në zonë dhe më larg shkon edhe ndikimi i saj. Në këtë kuadër, vlerat e përdorura për gjerësinë e zonës buferike sipas kategorisë së rrugës janë si më poshtë:

- Rrugë kombëtare të asfaltuara 1000 m në çdo anë të rrugës
- Hekurudhë 1000 m në çdo anë të linjës
- Rrugë dytësore me çakëll 500 m në çdo anë të rrugës
- Rrugë sezonale 250 m në çdo anë të rrugës

Harta e mëposhtme tregon zonat që preken nga ndikimi i infrastrukturës rrugore.

Përveç infrastrukturës rrugore ndikim të rëndësishëm mbi vlerat natyrore kanë edhe zonat e banuara, veçanërisht ato të zonave rurale të cilat kanë pasur një zhvillim urban tepër kaotik në 20 vitet e fundit. Për këtë arsye, vërehet një shpërndarje e gjerë e ndërtimeve edhe pse me intensitet të ulët dhe jo të organizuar në qendra të mirëfillta urbane.

### 3.3.2 Peshkimi i pakontrolluar

Në dy-tre dekadat e fundit peshkimi në Liqenin e Shkodrës ka qenë shpesh jashtë kontrollit. Peshkimi bëhet me mjete shfarosëse, në kohën e riprodhimit dhe nga persona pa licenca. Këto dukuri kanë dëmtuar ndjeshëm zhvillimin normal të stokut të peshqve. Një ndikim negativ mbi sasinë dhe strukturën e llojeve të peshqve, veçanërisht të llojeve të tregut, ka sjellë edhe periudha e shkurtër e ndalimit të peshkimit në Liqen, nga 15 Prill deri në 15 Maj për të gjitha llojet.

Moszbatimi korrekt për një periudhë të gjatë i kriterëve të mësipërme, ka dëmtuar strukturat e zinxhirëve ushqimorë dhe popullatat e peshqve, duke çuar në prishjen e strukturës llojore të resurseve peshkore, dhe rënie të prodhimit në përgjithësi. Aktualisht në Liqen dominojnë speciet e peshqve jo cilësore, si karasi (*Carassius gibelio*) dhe sharmaku (*Perca fluviatilis*).




FIGURA 15. HARTA E NDIKIMIT TË RRJETIT RRUGOR DHE ZONAT URBANE

---

**Përmirësimi i situatës së stokut të peshkut në Liqenin e Shkodrës kërkon marrjen e një sërë masash komplekse si më poshtë:**

- të bëhet një vlerësim i stokut të peshkut në Liqen nga ekspertë përkatës, dhe mbi këtë bazë të përcaktohet sasia dhe mosha e peshkut që do të peshkohet për çdo lloj dhe të respektohen në mënyrë korrekte koha e peshkimit dhe mjetet e peshkimit.
- të hartohen në bashkëpunim me shtetin malazez marrëveshje dhe plane të integruara të menaxhimit të peshkimit në Liqen dhe Lumin Buna, në mënyrë që të dy shtetet të heqin kufirin shtetëror për peshkim dhe të zbatohen të njëjtat ligje, rregulla dhe standarde siç i kanë vendosur shtetet evropiane për liqenet ndërkuftare.

### 3.3.3 Kullotja

Blegtoria është një komponent i rëndësishëm i aspekteve ekonomike dhe shoqërore në zonën e Shkodrës. Prodhimi blegtoral përbën rreth 50% të prodhimit total bujqësor në rang qarku. Për sa i përket strukturës së blegtorisë, në zonën e Shkodrës, 71% e përbëjnë bagëtitë e imta. Prodhimi blegtoral është i bazuar kryesisht në ekonomi familjare, me 90% të fermave që zhvillojnë aktivitetet e tyre bazuar vetëm në punë të familjes. Prirja e përgjithshme e fermerëve është mbarështimi i gjedhit dhe të imëtave, por edhe i derrave, pulave dhe i bletëve. Në zonat përreth Liqenit (njësitë administrative Rrethina, Gruemirë, Koplík Qendër dhe Kasttrat) mbarështohen afërsisht 7500 krerë lopë, 14000 krerë dele dhe 1800 krerë dhi, 4500 derra, 4500 koshere bletësh etj.

Përgjithësisht praktikohet mbarështimi i gjedhit në tufat të vogla, nën 50 krerë, duke përbërë një shqetësim mjedisor nga pikëpamja e mbi kullotjes në livadhet e pjesës lindore të Liqenit. Shumica e fermave me të imëta (dele dhe dhi) janë ferma për vetë-furnizim, të vogla, me një mesatare prej afro 20 dele/dhi. Shumica e fermave kanë teknologji disi primitive dhe pajisje të vjetruara. Fermat blegtorale nuk aplikojnë praktikatat e duhura të menaxhimit të mbeturinave, të ruajtjes së plehut dhe trajtimit të tyre. Vetëm pak ferma në zonë janë të specializuara për industrinë e përpunimit të qumështit, në përputhje me standardet e BE.

Zonat kryesore të kullotjes nga lopët dhe delet ndodhen në pjesën lindore të Liqenit, ose livadhet dhe fusha e Mbishkodrës, ndërsa dhitë kulloten në pjesën perëndimore të Liqenit, ose nga fshati i Paqes deri në Zogaj, dhe në kodrat veri-perëndimore të Liqenit, nga Kosani deri Kushe të Hotit.

Sistemet e të ushqyerit të të imëtave janë kryesisht sisteme ekstensive, me zhvendosje sezonale 4 – 5 muaj, sisteme kullotje mbi livadhe të përhershme, mbi kullota të përhershme pranë banesave, kullotje në kullota malore në largësi të shkurtra, por që kthehen në mbrëmje.

Kullotja intensive dëmton bimësinë, rrit erozionin e tokave përreth Liqenit dhe shton sasinë e ushqyesve në tokë në ujë dhe në sedimente, duke përshpejtuar procesin e eutrofikimit të ujërave të Liqenit.

Vitet e fundit vërehet një rënie e numrit të krerëve dhe një reduktim apo një largim nga tradita e shtegtimit sezonal (transhumanca).

### 3.3.4 Turizmi

Shkodra është rajoni që ka burime të pasura natyrore, që ofrojnë një potencial të lartë të turizmit natyror. Turizmi në Shkodër është kryesisht sezonal, në muajt Qershor-Gusht dhe zhvillohet në pjesën perëndimore të Liqenit të Shkodrës. Shiroka dhe Zogaj janë dy fshatra që gjenden në bregun perëndimor të Liqenit të Shkodrës, njihen si zona të vjetra turistike, duke ofruar një klimë



---

kurative, për shkak se gjenden midis Malit të Taraboshit dhe Liqenit. Përveç Shirokës dhe Zogaj në bregun perëndimor, dhe Stërbeqi dhe Gashaj në bregun lindor Pranë dhe përreth Liqenit gjenden gjithashtu qyteti i Shkodrës, i Koplikut, i Bajzës, i Podgoricës, i Tuzit, fshatra me pamje mjaft të bukura dhe tërheqëse. Jo shumë larg nga Shkodra ndodhen edhe disa vende, apo pika turistike malore, si Razma, Boga, Ducaj, Thethi, Lëpusha, Vermoshi etj. Shumë prej brigjeve të Liqenit janë të përshtatshme për plazhe.

Turizmi në Liqen mund të lidhet me turizmin rekreativ në Detin Adriatik dhe turizmin malor në pikat turistike malore, si Bogë, Razëm, Theth etj. Në Liqenin e Shkodrës janë kushtet për zhvillimin e turizmit të kombinuar, stacionar edhe tranzitor, veror dhe gjithëvjeter, duke zhvilluar:

- peshkimin sportiv,
- vrojtimin dhe fotografimin e shpendëve
- sportet ujore,
- rekreacionin dhe plazhin në brigjet e liqenit,
- turizmin kulturor,
- turizmin historik;

Për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm në zonën e Liqenit, krahas disa masave që duhen marrë, së pari duhet të menaxhohen derdhjet e ujërave të zeza në disa pika të liqenit dhe të reduktohet sasia e mbetjeve të ngurta përgjatë bregut të liqenit, si dhe të përdoren në Liqen sa të jetë e mundur mjetet transportuese elektrike (me bateri) në vend të mjeteve motorike me karburant.

### 3.3.5 Zjarret

Në Rajonin e Shkodrës, zjarret kanë një frekuencë të lartë, nga 2 deri në 15 vatra zjarrit në vit. Më shpesh ato ndodhin në Luginën e Shkrelit (Bzhetë, Razëm dhe Bogë). Zjarret përreth Liqenit të Shkodrës, janë më të shpeshta në Malin e Taraboshit, kryesisht mbi fshatin e Paqes dhe mbi Shirokë e Zogaj, dhe më të rralla në Kodrat e Moksetit, ose Gashaj – Kushe e Hotit. Pothuajse çdo vit shfaqen 2-3 vatra zjarrit mbi fshatin e Paqes dhe mbi Shirokë gjatë muajve korrik dhe Gusht duke djegur drurë pishë të zezë, shkurre, gjysmëshkurre, kullota me bimësi barishtore dhe me shumë lloje të faunës egër. Vatra më e madhe e zjarrit në Malin e Taraboshit, gjatë 10 viteve të fundit ka qenë me 30 Shtator të vitit 2015, ku u dogjën afro 30 hektarë me drurë dhe shkurre. Zjarre me madhësi mbi 10 hektarë në Malin e Taraboshit kanë ndodhur edhe me 22 Gusht 2020 dhe me 5 Gusht 2021. Edhe në Kodra e Tepes ka pasur një vatër të madhe zjarrit në vitin 2017, duke rrezikuar edhe shtëpitë banimit. Po kështu, në kodrat mbi fshatin Bardhaj me 10 Korrik 2017 dhe me 8 Gusht 2022 janë djegur dhjetëra hektarë me shkurre.

Ndikimi kryesor i zjarreve është reduktimi i mbulesës vegjetative, veçanërisht në sipërfaqet pyjore, ekspozimi i sipërfaqes dhe rritja e shkallës së erozionit të tokës.

### 3.3.6 Të tjera

Vlerësohet se ndërtimi i hidrocentraleve të mëdhenj në lumin Drin ka ndryshuar dinamikën natyrore të rrjedhjes së lumit me zbritje të nivelit mesatar dhe maksimal të nivelit të ujit në Liqen duke ndikuar negativisht mbi biodiversitetin, sepse shkaktojnë humbjen ose tjetërsimin e habitateve të riprodhimit të disa specieve të peshqve dhe specieve të tjera ujore, dhe pengojnë shtegtimin e shumë specieve të peshqve dhe specieve të tjera ujore. S

---

Dëmtimi i sipërfaqeve ligatinore natyrore së bashku me bimësinë pyjore aluvionale (shelgje, plepa, marina etj.) dhe bimësinë emergjente (kallamishte, zhavare, frysa, zunkthe etj) përgjatë brigjeve të Liqenit, ka sjell shkatërrimin e habitateve të riprodhimit të shumë specieve ujore, si të peshqve dhe për më tepër të shpendëve ujorë. Bimësia drunore dhe barishtore e bregut të liqenit ka pësuar dëmtime të mëdha në periudhën e monizmit. Bazuar në politikat izolimit, janë tjetërsua sipërfaqe të mëdha të habitateve ligatinore përgjatë bregut të liqenit, duke dëmtuar pyjet breg-lumore dhe bimësinë emergjente të bregut. Dëmtime të bimësisë së bregut, pavarësisht se në përmasa më të vogla janë raportuar edhe pas viteve 90-të, kryesisht për arsye të problemeve që ka mbartur periodha e tranzicionit, si varfëria, papunësia, mungesa e politikave mjedisore, mungesa e strategjive dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, etj.

Në brigjet e Liqenit, deri para disa vitesh është ushtruar në shumë raste një gjueti ilegale e shpendëve. Kjo ka ndikuar në një rënie të numrit të shpendëve ujorë të liqenit, veçanërisht të atyre migruese të kërkuar nga gjuetarët, si rosat, patat etj. Natyrisht që, në rënien e numrit të shpendëve ujorë në Liqenin e Shkodrës ka ndikuar edhe gjuetia e pakontrolluar edhe në vende të tjera më të cilat komunikojnë popullatat e Liqenit, si Rezervati i Velipojës, Delta e Bunës, Lumi Drin, Laguna e Kune - Vainit e më gjerë.

Ndalimi ligjor i gjuetisë në Zonat e Mbrojtura dhe masat për disiplinimin e gjuetisë në përgjithësi, forcimi i kontrollit nga administrata e zonave të mbrojtura, orientimi ambientalist i Shoqatës së Gjuetarëve dhe i shoqërisë civile, kanë ndikuar në shtimin e numrit të shpendëve në liqen dhe frekuentimin e shpeshtë të liqenit nga pelikani kaçurrel (*Pelicanus crispus*) gjatë viteve të fundit.

Vitet e fundit janë regjistruar temperature më të larta më pak reshje gjatë verës, por më shumë reshje dhe përmbytje gjatë stinëve dimër-pranverë, të cilat synojnë të intensifikohen në të ardhmen. Përmbytjet dhe erozioni shoqërohen me prurje të ngurta organike të pasura me Azot e Fosfor, me pasoja zhvillimin e bimësisë, cektësimin e Liqenit dhe eutrofikimin e ujërave të Liqenit. Po kështu, edhe prurjet e ngurta organike dhe të lëngëta, që sillen në Liqen përmes afluentëve (Vija e Vrakës, Përroj i Banushit, Përroi i Thatë etj.) dhe drenimit nga fermat bujqësore, nga shkarkimet urbane së bashku me ujërat e zeza, janë shumë të pasura me ushqyes (azot dhe fosfor), dhe shkaktojnë gjithashtu një rritje dhe përshpejtim të eutrofikimit të Liqenit. Së bashku me ujërat e zeza, në Liqen hyjnë edhe detergjentet e ndryshëm, të cilat krahas shpejtimit të eutrofikimit, përbëjnë një rrezik serioz për gjallesat e Liqenit dhe për shëndetin e njerëzve. Në Liqen hyjnë ujërat e zeza të qyteteve malazeze dhe të dy qyteteve tona (Koplik e Bajzë), të disa fshatrave përreth Liqenit, dhe ndonjë rast edhe të qytetit të Shkodrës. Shkarkimet e ujërave të zeza parashikohet të rriten si rezultat e shtimit të popullsisë dhe zhvillimit të turizmit përgjatë brigjeve të Liqenit. Po kështu parashikohet të rritet edhe përdorimi i plehrave kimike në pellgun e Liqenit në të ardhmen.

Gjatë viteve 80-të, në Liqenin e Shkodrës është zbatuar hedhja e rasatit të 9 llojeve të peshqve të panjohura për Liqenin (amuri, ballgjani, pëdhëmbza, karasi etj). Prej vitit 1990 ky proces është ndaluar dhe popullatat e tyre janë rralluar ndjeshëm, me përjashtim të karasit prusian (*Carassius gibelio*), i cili i është përshtatur shumë mirë kushteve eko-hidrologjike të liqenit. Dy-tre dekadat e fundit, në Liqenin e Shkodrës ka hyrë sharmaku (*Perca fluviatilis*), duke u përshtatur mirë dhe duke u shtuar shumë. Sharmaku është mjaft rezistent, shtohet lehtë dhe ka aftësi të madhe introduktuese. Ky së bashku me karasin janë dy prej specieve të rëndësishme të tregut të peshkut, që zihet në Liqen. Një zhvillim i dukshëm është venë re edhe tek dy lloje të tjera të introduktuara, notaku (*Pseudorasbora parva*) dhe barkulecit (*Gambusia holbrooki*). Ky zhvillim i shpejtë i këtyre llojeve të huaja ka ndikuar ndjeshëm në ndryshimin e strukturës së popullatave të llojeve vendase.

Dukuri të introduktimit të specie të huaja është vërejtur edhe tek disa specie bimore tokësore dhe ujore. Kështu, prej dekadash ka hyrë dhe është zhvilluar shumë karthi (*Amorpha fruticosa*), një shkurre me origjinë nga Amerika, e cila ka pushtuar hapësira të mëdha përgjatë brigjeve të Liqenit (veçanërisht bregut lindor) dhe të Lumit Buna, duke zëvendësuar specie vendase.




FIGURA 16. HARTA E ZONAVE QË NDIKOHEN NGA AKTIVITETET KRYESORE



Dekadën e fundit kanë hyrë dhe po përhapen me shpejtësi edhe tre specie barishtore me origjinë nga Amerika e Veriut: dy specie ujore makrofite, (*Elodea canadensis*, *E. nuttallii*), që kanë pushtuar sipërfaqe të mëdha të habitateve ujore në Lumin Buna dhe në pjesën jugore të Liqenit duke krijuar masa të dendura bimore dhe një specie tokësore, (*Ambrosia artemisiifolia*), që është përhapur përgjatë brigjeve lindore të Liqenit. Mendohet se në përhapjen dhe zhvillimin e shpejtë të tyre ka ndikuar ndotja e ujit dhe ngrohja globale.

Vështirësia në gjeo-referencimin e këtyre kërcënimeve e bën të pamundur përfshirjen e tyre në analizën e përgjithshme të kërcënimeve ndaj vlerave natyrore.

### 3.3.7 Harta totale e kërcënimeve

Harta totale e kërcënimeve tregon në mënyrë të përmbledhur të gjitha zonat që ndikohen nga aktivitetet e ndryshme që zhvillohen brenda parkut. Për përgatitjen e kësaj harte secilin nga kërcënimet e kemi vlerësuar si të pranishëm (1) ose jo të pranishëm (0) për çdo kuadrat të rrjetit kuadratik. Më pas të gjitha vlerat e kërcënimeve të ndryshme janë mbledhur për secilin kuadrat Vlera nominale që ka rezultuar është normalizuar sipas formulës  $x_i \text{ Normal} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks, 1967), i cili përpiket të gjejë grupime natyrore të të dhënave për të krijuar klasat. Klasat që rezultojnë kanë variacion maksimal midis klasave individuale dhe më pak variacion brenda çdo klase. Në rastin e vlerës totale natyrore klasat janë ndarë si më poshtë:

- Klasa 1 – Pak e Rrezikuar – Vlerat 0.0000 - 0.312476
- Klasa 2 – Mesatarisht e Rrezikuar – Vlerat 0.312477 - 0.611261
- Klasa 3 – Shumë e Rrezikuar – Vlerat 0.611262 - 1.0000

Nga analiza e rezultateve vërehet se pjesa më e madhe e territorit të parkut është pak (39%) ose mesatarisht (52%) e rrezikuar nga kërcënimet që janë marrë në konsideratë për këtë analizë. Ndërkohë që vetëm 9% e territorit të zonës së mbrojtur është klasifikuar si shumë e rrezikuar.





FIGURA 17. SHPËRNDARJA E SIPËRFAQES SIPAS KLASAVE TË RREZIKUT

Pjesa më e madhe e zonave të klasifikuara si “Shumë të rrezikuara” ndodhen në pjesën jugore të parkut, përgjatë rrugës për në Shirokë e Zogaj, ku janë përqendruar edhe aktivitetet kryesore turistike e të peshkimit. Njëkohësisht, disa zona shumë të rrezikuara janë edhe në pjesën qendrore të bregut lindor të liqenit ku mbizotëron kullotja e livadheve breg-lumore dhe peshkimi.




**FIGURA 18. HARTA E VLERËS SË KËRCËNIMEVE**

### 3.4 Harta analitike

Kombinimi i hartës totale të vlerave me hartën totale të rrezikut evidenton zonat me vlera të larta natyrore të cilat nuk kërcënohen nga aktivitetet ekonomike të banorëve që përdorin burimet natyrore. Vlera e secilit kuadrat në rrjetin kuadratik përcaktohet nga rezultati i diferencës  $V_{\text{finale}} = V_{\text{nat}} - V_{\text{kërcënime}}$ . Edhen në këtë rast vlerat nominale (ku përfshihen edhe vlera negative) janë normalizuar sipas formulës  $x_i \text{ Normal} = (x_i - \text{Min}(x)) / (\text{Max}(x) - \text{Min}(x))$ . Vlerat e normalizuara janë klasifikuar në tre klasa duke përdorur algoritmin statistikor (Jenks, 1967), i cili përpiqet të gjejë grupime natyrore të të dhënave për të krijuar klasat. Klasat që rezultojnë kanë variacion maksimal midis klasave individuale dhe më pak variacion brenda çdo klase. Në rastin e vlerës totale natyrore klasat janë ndarë si më poshtë:


- Klasa 1 – Pak e Përshtatshme – Vlerat 0.000000 - 0.258068
- Klasa 2 – Mesatarisht e Përshtatshme – Vlerat 0.258069 - 0.485319
- Klasa 3 – Shumë e Përshtatshme – Vlerat 0.485320 - 1.000000

Analiza e rezultateve tregon se rreth dy të pestat (39%) e territorit të zonës së mbrojtur janë shumë të përshtatshme për ruajtjen e vlerave natyrore pasi përfshin territore me vlera natyrore që janë pak të rrezikuara nga aktivitetet apo përdorimet njerëzore. Ndërkohë që edhe një e pesta e territorit (21%), klasifikuar si mesatarisht e përshtatshme, mund të përdoret për ruajtjen e natyrës duke menaxhuar e kontrolluar me kujdes aktivitetet dhe përdorimet e burimeve natyrore që ndodhin brenda saj. Nga ana tjetër, 40% e territorit është klasifikuar si pak e përshtatshme për ruajtjen e natyrës, për shkak të vlerave të munguara natyrore dhe/ose kërcënimit serioz nga aktivitetet njerëzore.



**FIGURA 19. SHPËRNDARJA E SIPËRFAQES SIPAS KLASAVE TË PËRSHTATSHMËRISË PËR RUAJTJEN E NATYRËS**






**FIGURA 20. HARTA E PËRSHTATSHMËRISË PËR RUAJTJEN E NATYRËS (VLERA TOTALE)**

Bazuar në rezultatet e analizës së mësipërme, për zonën e liqenit të Shkodrës do të propozonim tre apo katër zonat të veçanta për tu shpallur si pjesë e rrjetit Natura 2000. Zona e parë dhe më e madhe në sipërfaqe, përfshin pjesën qendrore dhe veriperëndimore të Liqenit të Shkodrës. Kjo zonë përfshin mjedise të përshtatshme për ruajtjen e shumë llojeve të peshqve dhe të shpendëve

ujorë e si e tillë do të propozohet edhe si SPA (Direktiva e Shpendëve) edhe si SCI (Direktiva e Habitave). Zona e propozuar ka një sipërfaqe të përafërt prej 6,942 ha.



**FIGURA 21. KUFIRI I PROPOZUAR PËR ZONËN NATURA 2000**


Zona e dytë përfshin habitatet breg-lumore në pjesën veriore të liqenit, ku përfshihen disa habitate të rëndësishme komunitare, të cilat veç të tjerash janë të rëndësishme edhe për shumimin e disa llojeve të peshqve të zonës. Zona e propozuar ka një sipërfaqe të përafërt prej 3,677 ha. Zona e tretë përfshin livadhet dhe habitate breg-lumore në pjesën juglindore të liqenit, pranë qytetit të Shkodrës, të cilat gjithashtu janë të rëndësishme si për disa lloje peshqish ashtu edhe për shpendët ujorë që popullojnë liqenin. Sipërfaqja e kësaj zone të propozuar është 1,225 ha.

Zona e katërt shtrihet kryesisht përgjatë Malit të Taraboshit dhe përfshin habitate të veçanta kullosore e shkëmbore të listuar në anekset e Direktivës së Habitaveve. Kjo zonë mund të përfshijë edhe një pjesë të bregut të liqenit pranë fshatit Zogaj, e cila paraqet vlera të larta natyrore. Sipërfaqja e përafërt e kësaj zone është 1,543 ha.

Me interes është edhe harta e zonave të konfliktit, e cila tregon zonat që kanë vlera të larta natyrore por që kërcënohen seriozisht nga aktivitetet dhe përdorimet njerëzore. Identifikimi i zonave të konfliktit është bërë duke krahasuar rezultatet e vlerës natyrore me rezultatet e kërcënimeve, sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme.


**TABELA 8. IDENTIFIKIMI I ZONAVE TË KONFLIKTIT**

Vlera natyrore	Kërcënimet	Konflikti	Numri i kuadrateve	% territorit
Shumë e lartë	Shumë e rrezikuar	I lartë	14	5%
Shumë e lartë	Mesatarisht e rrezikuar	I lartë	18	6%
Shumë e lartë	Pak e rrezikuar	I Ulët	11	4%
Mesatare	Shumë e rrezikuar	I Lartë	10	3%
Mesatare	Mesatarisht e rrezikuar	Mesatar	38	13%
Mesatare	Pak e rrezikuar	I Ulët	32	11%
E Ulët	Shumë e rrezikuar	I Ulët	3	1%
E Ulët	Mesatarisht e rrezikuar	I Ulët	100	33%
E Ulët	Pak e rrezikuar	I Ulët	74	25%



**FIGURA 22. SHPËRNDARJA E SIPËRFAQES SIPAS KLASAVE TË KONFLIKTIT**





**FIGURA 23. KUFIRI I PROPOZUAR PËR ZONËN NATURA 2000 ME ZONAT E KONFLIKTIT**

Normalisht që në shumicën e territorit të zonës së mbrojtur (73%) nuk ka konflikte midis ruajtjes së vlerave natyrore dhe aktiviteteve apo përdorimeve njerëzore të këtyre vlerave. Vetëm 14% e territorit është klasifikuar si zona ku mund të ketë konflikte serioze midis ruajtjes dhe përdorimit të burimeve natyrore. Sidoqoftë, nisur nga lloji dhe natyra e aktiviteteve apo kërcënimeve të

---

analizuara, vlerësojmë që një angazhim i kujdesshëm dhe kontroll më i mirë i territorit nga administrata e zonave të mbrojtura si dhe një ndërgjegjësim më i mirë i banorëve për vlerat e rëndësishme të zonës do të kontribuonte ndjeshëm në uljen e konflikteve dhe garantimin e ruajtjes së vlerave natyrore.

Nga katër zonat e propozuara për tu përfshirë në rrjetin Natura 2000, zona e tretë dhe e katërt kanë më shumë sipërfaqe ku konflikti midis ruajtjes së vlerave natyrore dhe përdorimit të tyre nga komunitetet lokale është i lartë. Megjithatë, nëse do të përjashtonim këto zona nga sipërfaqja e propozuar për Natura 2000, do të humbasim mundësinë e ruajtjes së disa habitateve shumë specifike e të rëndësishëm (habitata breg-lumore e malore) që përdoren nga një numër i madh e i larmishëm kafshësh të egra.

Në këtë kuadër është e domosdoshme të punohet për zbutjen e konflikteve midis ruajtjes së vlerave natyrore dhe përdorimit të tyre nga banorët. Menaxhimi i zonës Natura 2000 do të kërkonte një bashkëpunim më të ngushtë me palët e interesuara dhe specifikisht me përdoruesit e burimeve natyrore në zonë për të minimizuar ndikimin e aktiviteteve të tyre mbi vlerat natyrore të zonës duke garantuar statusin e favorshëm të ruajtjes për llojet dhe habitatet e rëndësishme. Pikërisht ky do të jetë një nga qëllimet kryesore të takimit të dytë me palët e interesuara në zonë.

## 4 Procesi pjesëmarrës

Procesi i identifikimit dhe analizës së vlerave natyrore, kërcënimeve dhe presioneve aktuale e potenciale ndaj tyre është i rëndësishëm për të kuptuar në shumë mbi masat dhe aktivitetet e mundshme të ruajtjes së natyrës që duhen zbatuar në zonë. Pjesëmarrja e gjithë aktorëve të interesuar në këtë proces i jep një vlerë të veçantë përpjekjeve për të ruajtur të pandryshuar trashëgiminë natyrore, si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar/ndërkombëtar.

### 4.1 Takimi i parë

Takimi i parë me aktorët është zhvilluar në **x.xx.2023** në Shkodër, në mjediset e restorant Alder. Lista e pjesëmarrësve u përgatit duke marrë parasysh një bazë të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë vendimmarrësit në nivel lokal, stafin e administratës së zonës së mbrojtur, përfaqësuesit e komunitetit lokal dhe përdoruesit e burimeve lokale.

Në këtë takim pjesëmarrësit u informuan fillimisht mbi parimet bazë të konceptit Natura 2000, rëndësia, përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin prej saj. Ata u njohën me kuadrin ligjor lidhur me rrjetin Natura 2000, si dhe hapat që duhet të ndërmerren nga vendet candidate gjatë procesit të harmonizimit të direktivave të BE-së. Direktiva e Habitaveve synon ruajtjen afatgjatë të biodiversitetit duke marrë parasysh kërkesat ekonomike, sociale, kulturore dhe rajonale. Praktikrat e mira të menaxhimit të zonave Natura 2000 forcojnë lidhjet midis trashëgimisë natyrore dhe kulturore në BE dhe krijojnë mundësi shtesë për aktivitete ekonomike që përdorin burime natyrore (turizmi mjedisor, aktivitete në natyrë, promovimi i produkteve lokale, etj.) dhe krijojnë vende të reja pune e të ardhura shtesë për banorët e zonës. Gjithashtu, pjesëmarrësit u njohën edhe me mundësitë e financimit për zonat Natura 2000. BE ka një sërë programesh që mund të mbështesin aktivitete për menaxhimi, ruajtjen dhe promovimin e zonave Natura 2000, si programi LIFE (nën-programi Nature), Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural (EAFRD), Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF), Fondi Social Evropian (ESF), Fondi Evropian i Marinës dhe Peshkimit (EMFF), etj. Programi Horizon 2020 mund të ofrojë fonde për aktivitete lidhur me kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin e njohurive.



---

Sidoqoftë, elementi kryesor i takimit ishte shpjegimi dhe ilustrimi i koncepteve dhe hapave që do të ndiqen gjatë zbatimit të Qasjes Inovative me Pjesëmarrje bazuar në Ekosistem. Pjesëmarrësit u njohën me të dhënat paraprake të grumbulluara për zonën dhe diskutuan gjerësisht për identifikimi hapësinor të vlerave natyrore dhe kulturore dhe presioneve dhe kërcënimeve të lidhura me to. Gjatë takimit u mblodhën sugjerime dhe informacione të vlefshme nga palët pjesëmarrëse mbi vlerat e biodiversitetit të cilat janë përdorur në studimet ekologjike të ekspertëve lokalë dhe kanë ndihmuar në analizimin e mëtejshëm të të dhënave. Të gjitha të dhënat e mblledhura u gjeoreferencuan dhe digjitalizuan në GIS.

Gjatë takimit u diskutua edhe për listën e aktorëve të interesuar për përdorimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore të zonës, dhe pjesëmarrësit dhanë sugjerime mjaft të vlefshme për zgjerimin e listës së aktorëve dhe institucioneve të interesuara dhe rolin/angazhimin e tyre në përcaktimin dhe menaxhimin e zonës Natyra 2000.

Veç sa më sipër, eksperti lokal, Prof. Dr. Marash Rakaj, ka zhvilluar një sërë takimesh dypalëshe me institucione dhe aktorë të tjerë lokalë për të diskutuar mbi vlerat natyrore dhe kërcënimet ndaj këtyre vlerave në Parkun Natyror Liqeni i Shkodrës.

## 4.2 Takimi i dytë

Takimi i dytë u zhvillua në tetor 2023 dhe u fokusua drejtpërdrejt në diskutimet konsultative midis pjesëmarrësve mbi bashkë shqyrtimin e rezultateve të grumbulluara dhe të analizuara deri më tani. Një sërë prezantimesh mbi vlerat natyrore të identifikuara brenda zonës së studimit iu paraqitën pjesëmarrësve, të cilët diskutuan mbi vlerat natyrore të identifikuara (habitatet, speciet bimore dhe shtazore) dhe identifikimin e përfitimeve socio-ekonomike nga përdorimi i burimeve natyrore për komunitetin lokal si dhe presionet dhe kërcënimet aktuale dhe potenciale që ndikojnë në ekosistemet natyrore.


Identifikimi dhe adresimi i konflikteve është kryer duke përdorur të dhënat e marra nga fazat e mëparshme të vlerësimit, në mënyrë që të identifikohen interesat apo përdorimet konfliktuale të vlerave natyrore në zonë dhe aktorët përgjegjës për këto përdorime. Analiza shqyrton se si niveli i përdorimit/interesit rrezikon degradimin e ekosistemeve dhe shërbimeve që rrjedhin prej tyre dhe ndikon në vendimet lidhur me menaxhimin e zonës dhe vlerave natyrore (habitate, lloje). Paraqitja e analizës në hartë ndihmon mjaft diskutimin dhe arritjen e kompromisit për zgjidhjen e situatave konfliktuale.

Për të kuptuar më mirë lidhjen midis vlerave natyrore, përdoruesve, përfitimeve, aktiviteteve dhe rreziqeve potenciale që rrezikojnë këto vlera, është zhvilluar dhe prezantuar tek pjesëmarrësit një model konceptual për ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Modeli lidh vlerat natyrore (shoqërimet bimore dhe llojet e habitateve) me sektorët socio-ekonomikë (blegtoaria, bujqësia, turizmi, peshkimi) për të përshkruar, sipas tyre, se çfarë përfitimesh për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës mund të gjenerohen nga ruajtja e habitateve që funksionojnë mirë dhe çfarë masash duhet të zbatohen për të ruajtur këto përfitime. Përveç kësaj, u identifikuan edhe përdoruesit (palët e interesuara) dhe aktivitetet që përfitojnë nga këto vlera të lidhura me bimësinë apo habitatet specifike. Më tej, pjesëmarrësit evidentuan rreziqet aktuale dhe potenciale që përdoruesit të humbasin përfitimet e ofruara nga vlerat natyrore të zonës.

Modeli konceptual i krijuar si më sipër ndihmon në sqarimin e lidhjeve midis komponentëve të ndryshëm të modelit dhe natyrën e marrëdhënieve midis vlerave, përfitimeve shoqëruese për përdoruesit lokalë dhe rreziqeve për të humbur këto vlera. Kjo "tablo e gjerë" shërben për t'u



përshtatur me të gjitha nevojat dhe pritshmëritë e të gjitha palëve të përfshira në procesin e identifikimit dhe menaxhimit të zonave Natura 2000.



**FIGURA 24. MODELI KONCEPTUAL LIQENI I SHKODRËS**

Një qasje e tillë është me rëndësi themelore për të garantuar përcaktimin e kufirit më të mirë të mundshëm të zonës Natura 2000 duke integruar elemente të rëndësishëm në kriteret e vlerësimit të zonës, i cili sipas përcaktimeve strikte të Direktivës së Habiteteve duhet të bazohet vetëm në vlerat ekologjike.

Vlen të theksohet se gjatë zbatimit të kësaj qasjeje vazhdimisht i është dhënë përparësi "përfitimeve që njerëzit mund të marrin nga natyra" dhe jo "çfarë njerëzit normalisht bëjnë kundër natyrës". Në këtë kuadër, modeli konceptual shkon përtej "vlerave natyrore" dhe "kërcënimeve dhe presioneve" ndaj tyre, duke identifikuar e analizuar "përfitimet për njerëzit" dhe zbutur/zgjdhur konfliktet e mundshme gjatë sigurimit të vazhdueshëm të këtyre përfitimeve. Kjo përbën një parakusht të rëndësishëm për të garantuar ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat Natyra 2000.

## 5 Përfundime e rekomandime

Bazuar në rezultatet e analizës së më sipërme mund të arrijmë në përfundimin se zona përreth Liqenit të Shkodrës është një zonë me vlera të veçanta natyrore të cilat kanë interes të lartë ruajtjeje edhe për komunitetin evropian. Identifikimi i katër zonave potenciale si pjesë e rrjetit Natura 2000 to të kontribuojë ndjeshëm në ruajtjen afatgjatë të këtyre vlerave natyrore, duke krijuar njëkohësisht mundësi më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Analiza e kryer në kuadër të këtij vlerësimi, nxjerr në pah edhe një sërë mungesash e problematikash lidhur me procesin e identifikimit dhe vlerësimit të vlerave natyrore në përgjithësi. Kështu mund të përmendim mungesën e të dhënave të besueshme në seri kohore mbi stokun e peshkut në liqen dhe tendencat e zhvillimit të tij në vite, po ashtu, mungojnë të dhënat e gjeo-

---

referencuara mbi lëvizjen e popullatave të peshkut në liqen dhe identifikimin e zonave më të përshtatshme e të preferuara nga llojet e ndryshme të peshqve për ushqim e shumim.

Edhe pse njohuritë për habitatet e rëndësishme në zonën e Liqenit të Shkodrës nuk mungojnë, është e nevojshme të thellohen studimet për tipe te veçanta habitatesh, veçanërisht për habitatet liqenore dhe ato përgjatë Malit të Taraboshit. Gjithashtu, puna e mirë që ka nisur në identifikimin dhe inventarizimin e llojeve shtazore, kryesisht shpendëve, duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen duke zgjeruar listën e llojeve dhe përditësuar vazhdimisht bazat e të dhënave ekzistuese (BiONNA dhe WiMS).

Nga ana tjetër, mbetet ende shumë punë për të bërë në konsolidimin dhe përfshirjen më të gjerë të aktorëve të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të zonës, në procesin e menaxhimit të burimeve natyrore për të garantuar ruajtjen afatgjatë të vlerave të biodiversitetit. Përveç, peshkatarëve, të cilët tashmë janë një grup i mirë-identifikuar dhe i organizuar, grupet e tjera të aktorëve (bujqësia, blegtoaria, turizmi) janë të pa organizuar dhe vështirësisht të përfaqësuar në forumet e diskutimit mbi përdorimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Po ashtu, shoqëria civile, në përgjithësi, nuk ka kapacitetet e nevojshme dhe aftësitë e duhura për të mobilizuar e përfaqësuar denjësisht të gjitha shtresat dhe grupet e interesit në komunitetet lokale përreth Liqenit të Shkodrës.

Pilotimi i “Qasjes Inovative për Identifikimin e Zonave Natura 2000” në zonën e Liqenit të Shkodrës ishte një përvojë pozitive, e cila jo vetëm lehtëso procesin e identifikimit të zonave potenciale Natura 2000, por krijoi edhe kushtet dhe instrumentet e duhura për fillimin dhe vazhdimin e një dialogu konstruktiv midis palëve dhe aktorëve të ndryshëm me qëllim garantimin e menaxhimit të qëndrueshëm të vlerave natyrore të zonës me qëllim ruajtjen e habitateve dhe llojeve të rëndësishme.

Përvoja e krijuar gjatë zbatimit të kësaj metodologjie evidentoi edhe njëherë vështirësinë e zbatimit korrekt të proceseve me pjesëmarrje në Shqipëri dhe punën e madhe që duhet bërë ende, jo vetëm për informimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të ndryshme të interesit, por edhe për nxitjen e ndjenjës së tyre të përfaqësimit dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme për pjesëmarrje aktive në mirëqeverisjen e burimeve natyrore. Njëkohësisht, është e rëndësishme të punohet edhe me institucionet qeveritare (në nivel qendror e vendor) për të përmirësuar mekanizmat e bashkëpunimit dhe gjithë-përfshirjes në proceset vendim-marrëse lidhur me menaxhimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore.

Nisur nga përfundimet e mësipërme mund të rekomandojmë sa më poshtë:

- Qasja Inovative për identifikimin e zonave Natura 2000 të përdoret si qasje standard në gjithë procesin e identifikimit dhe vlerësimit të zonave të propozuara si pjesë e rrjetit Natura 2000 në Shqipëri.
- Të mbështetet puna kërkimore-shkencore e universiteteve dhe grupeve të tjera kërkimore, veçanërisht në grumbullimin dhe thellimin e njohurive lidhur me identifikimin dhe kartografin e habitateve dhe zonave të përhapjes së llojeve me rëndësi ruajtjeje, të listuar në anekset e Direktivës së Habitave dhe Direktivës së Shpendëve.
- Të punohet më shumë në drejtim të informimit dhe edukimit të aktorëve të ndryshëm lidhur me konceptet e rrjetit Natura 2000.
- Të punohet për forcimin e kapaciteteve të grupeve lokale të aktorëve dhe përmirësimin e përfaqësimit të tyre.